



SHKPKK

Shoqata Kombëtare e
Pyjeve dhe Kullotave
Komunale

Kurora e Gjelbër



Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Tiranë (Viti i njëmbëdhjetë i botimit) Nr. 83, qershor 2008 Çmimi 20 lekë

Thellimi i reformës, tarifat e diferencuara të kullotjes dhe pagesa e shërbimeve mjedisore, mundësi për të siguruar qëndrueshmëri në realizimin e objektivave

- Disa nga gjetjet kryesore të misionit të BB për vlerësimin afatmesëm të Projektit -

Misioni për rishikimin afatmesëm i Bankës Botërore, Agjencisë suedeze për Zhvillim (Sida) dhe organizatës holandeze për Zhvillim (SNV) u realizua nga data 9 deri 25 qershor 2008, për të vlerësuar progresin në zbatimin e Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore.

Gjetjet kryesore

Në termat e zbatimit të Projektit misioni vlerësoi përmirësimin substancial, eficientë dhe përshtetshëm në arritjen e objektivave, veçanërisht bazuar në planin e zbatimit të Projektit, të miratuar nga MMPAU në nëntor 2007. Formalizimi i transferimit të pyjeve e kullotave në NJQV konfirmon se Objektivi i Zhvillimit të Projektit mbetet i lartë në axhendën e Qeverisë. Si rezultat i transferimit, mbetet urgjente përshtatja e kuadrit institucional për të realizuar ndërtimin e kapaciteteve në komuna, shërbimin e ekstensionit apo shërbimet e kontrollit. Ky ka qenë objektivi i rëndësishëm kur u përgatit Projekti, por tashmë është bërë më i rëndësishëm, pasi komunave u është transferuar jo vetëm drejta e përdorimit, por edhe drejta e pronësisë.

Qëndrueshmëria

Transferimi i pronësisë dhe të drejtës së përdorimit për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave tek NJQV siguron nxitje më të mirë për të menaxhuar e ruajtur këto burime natyrore, të cilat tani janë më afër popullit që i përdor e i mbron ato. Vendimi i KM, Nr. 22, dt 9.1.2008, siguron kuadrin për të krijuar e mirëmbajtur menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale. NJQV dhe shoqatat e pyjeve e kullotave komunale kanë fituar përvojë, që është një bazë e mirë për punën në të ardhmen, për të përmirësuar menaxhimin e rritur të ardhurat nga këto burime. Procesi i pjesëmarrjes ka rezultuar në vlerë të shtuar jo vetëm për rritjen e pronësisë nëpërmjet procesit të identifikimit të kufijve e të drejtës individuale të përdorimit, por edhe nëpërmjet ekspozimit të komuniteteve me idetë e praktikën e menaxhimit të qëndrueshëm. Nëpërmjet transferimit të kullotave dhe tokave pyjore në komuna një mundësi e re për përdorimin e qëndrueshëm të kullotave është hapur nëpërmjet tarifave të kullotjes. Këto tarifa, përpara grumbulloheshin nga DSHP, por pasi transferimi të finalizohet do të mbledhen nga komunat. Misioni beson se një mekanizëm i menaxhuar mirë i grumbullimit të tarifave, mund të shtrojë një rrugë për të siguruar frenim të mbikullotjes në territoret e degraduara apo nxitje për të përdorur territoret që aktualisht nuk arrihen nga kullotja. Për më tepër, të ardhurat që sigurohen nga tarifat e kullotjes mund të investohen në menaxhimin e kullotave dhe përmirësimin e cilësisë së tyre.

Një nga arsyet e Vendimit të Qeverisë për transferimin e pyjeve dhe kullotave ishte sigurimi i mbrotjes e menaxhimit më të mirë të këtyre burimeve natyrore në përgjithësi e veçanërisht kontroll më të mirë të zjarreve. NJQV besojnë se menaxhimi i zjarreve nuk do të jetë problem serioz, tani që pyjet e kullotat janë transferuar në pronësi komunale dhe se populli që shpesh i ka vënë zjarret, do t'i shohë këto toka si prona të tij e do të bëjë kujdes për të parandaluar zjarret. Sidoqoftë, që komunat t'i shfrytëzojnë avantazhet e këtyre oportuniteteve dhe Projekti të bëhet i qëndrueshëm edhe pas mbylljes së tij, është me rëndësi ngritja e strukturave të menaxhimit. Kjo lidhet me një reformë institucionale të suksesshme për kontrollin e menaxhimin e pyjeve dhe kullotave. Transferimi i pyjeve dhe kullotave shtetërore në komuna kërkon riorganizim substancial të funksioneve institucionale dhe rialokimin e burimeve. Përderisa reforma e kërkuar të jetë kompletuar brenda jetës së Projektit, zhvillimi i qëndrueshëm i tokave të larta e i zonave malore të ndjeshme ndaj erozionit, tashmë transferuar te komunat, nuk mund të jenë të sigurta e të mirëmbajtura.

Për arsye se burimet qeveritare janë të kufizuara dhe duket se do të jenë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e së ardhmes, është çasti i duhur për të eksploruar burimet alternative për të siguruar të ardhura, që do të kontribuojnë për ekonominë e NJQV. Është e nevojshme për të siguruar për zonat malore me disavatazhe, një mbështetje të vazhdueshme strukturore, si në gjithë shtetet anëtare të BE apo në shumë vende të tjera. Shumica e komunave nuk i kanë mundësitë financiare për të ndaluar degradimin e përmirësuar pyjet dhe kullotat që kanë marrë, në mënyrë që të kthehen në burime të qëndrueshme të ardhurash për banorët e tyre.

Vijon në fq. 4

ZJARRET NË PYJE E KULLOTA SHQETËSIM I DITËS



Nga aktivitetet e SHKPKK dhe SNV

SEMINAR PËR PËRMIRËSIMIN E METODIKËS SË HARTIMIT TË PLANEVE TË MENAXHIMIT

Me 18 qershor 2008, në një nga sallat e "Tirana International Hotel", nën drejtimin dhe mbështetjen e SNV-së, u organizua një seminar për paraqitjen e rezultateve të grupit të punës, në detyrën e ngarkuar për përmirësimin e metodikës së planeve të menaxhimit. Në seminar mori pjesë një grup përfaqësuesish nga Drejtoria e Politikave Pyjore në MMPAU, kryesuar nga drejtori i kësaj Drejtorie, Nehat Çollaku. Morën pjesë gjithashtu përfaqësues nga PZHBN, specialistë të angazhuar në hartimin e planeve të menaxhimit nga subjektet private, si dhe ekspertë e koordinatorë të SNV-së.

Gjatë seminarit, grupi mikst i punës i ngarkuar nga SNV-ja, nëpërmjet ekspertit të njohur austriak Franz Hillgarter dhe ekspertit shqiptar, inxh. Ferdin Liçaj, paraqiti gjetjet dhe rezultatet e arritura gjatë muajit të kaluar, në disa komuna të Shqipërisë, në drejtim të formave të menaxhimit tradicional të pyjeve e kullotave prej familjeve fermere në rajone të ndryshme të vendit tonë. Në të njëjtën kohë, ekspertët paraqitën edhe rezultatet e propozimeve të tyre konkrete për përmirësimin dhe plotësimin e treguesve të metodikës. Pas përfundimit të paraqitjes së punës së bërë, nga të pranishmit u bënë shumë pyetje e u dhanë sugjerime për përmirësime e qartësime të mëtejshme të treguesve e formulimeve në hallkat kryesore metodologjike të planeve të menaxhimit.

Rezultatet e grupit të punës u vlerësuan nga pjesëmarrësit, të cilët ndanë të njëjtën mendim për të pasur plane menaxhimi që duhen hartuar me pjesëmarrjen e fermerëve, të jenë të lexueshëm nga ata e t'u shërbejnë interesave të tyre, pa cënuar aspak edhe interesat e mjedisit shoqëror në zonat ku banojnë.

Koorresp. i "Kurorës"



NGA VALBONA NË PICAR

(Në gjurmët e misionit
supervizues të BB në PZHBN)

nga HAKI KOLA

Vijon nga numri i kaluar

Faqe 2, 3

REFORMA NË PYJE E KULLOTA LYPSET TË VAZHDOJË

REXHEP NDREU

Koordinator i Federatës së Pyjeve e Kullotave
Komunale, Dibër



Faqe 5

NGA VALBONA NË PICAR

(Në gjurmët e misionit supervizues të Bankës Botërore në Projektin e Zhvillimit të Burimeve Natyrore)

nga HAKI KOLA

Kullotat mund t'i japin Picarit mbi 100 mijë dollarë të ardhura në vit

Picari mban mbi 45 mijë të imëta. Çimi, kryetar i komunës, propozon të mos futemi në zyrë, por të nisemi e të shohim nga një pllajë në mes të komunës bukuritë e maleve, pllajave e luginave të Picarit. Drejtoresha e DSHP, bijë e Picarit, e përkrash propozimin dhe të gjithëve u jepet mundësia të shohin kopetë e deleve "të privileguara" nga lagështia e fillimverës, akoma të pangjitura në malet e larta, e të vazhdojnë debatin e nisur në Tepelenë, për mundësitë që kanë komunat për të menaxhuar më mirë se shteti pasuritë që natyra u ka falur. Roberti pyet për tarifën që aplikohen për çdo kokë dele dhe kush i mbledh ato. Çimi sqaron se Vendimi i KM, ia ka dhënë të gjitha kullotat tradicionale në pronësi komunës, por akoma dorëzimi i territorit nuk është bërë me procesverbal nga DSHP, kështu që edhe këtë vit të ardhurat do t'i grumbullojë Shërbimi Pyjor. Ai shpjegon se nga 45 mijë të imëta që ka Picari mund të mbledhen çdo vit rreth 100 mijë dollarë, që në vitet në vazhdim do të mbeten në komunë e do të përdoren prej saj, për punësimin e banorëve dhe përmirësimin në përgjithësi të kapacitetit të kullotave.

Gardhet e para në Picarin e kërcënuar nga tragjedia e të përbashkëtës

Lenarti ndalet të filmojë një gardh të bërë me tel gabion në gjatësi mbi një kilometër, një gardh i bukur, i qëndisur nga një prej banorëve të kthyer nga kurbeti, për të mbrojtur shkurret prej lisi, si dhe barin në kodrën që i kishin lënë trashëgim të parët. Shparthi e Qarri, së bashku me Shkozën, Panjen e Frashërin, duke i patur majat e tyre të mbrojtura nga gojë e bagëti, kanë hedhur shtat e po i kalojnë dy metër lartësi. Fermeri e ka populluar këtë pyll të vogël me lepuj e kafshë të tjera gjahu dhe vitin që vjen pret të marrë të ardhurat e para të investimit të të kryer.

Tek shoh pyllin e rritur brenda gardhit, mendja më thotë se Picari do të "kurohet" shpejt nga tragjedia e të përbashkëtës. Gardhi është shenja e parë, që banorët po largohen nga bota virtuale dhe po mendojnë të ndërtojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre. Fermerët e Picarit kanë organizuar një javë më parë një vizitë në Fedratën Rajonale të përdoruesve të pyjeve e kullotave të Korçës, për të parë se si i kanë ndarë e po i rrisin pyjet fermeret e Liqenasit dhe ata të komunës Buçimas në Pogradec. Për pyjet e fermerëve të fshatit Peshkëpi, kryetari i shoqatës së përdoruesve të Picarit tha: Atje pamë një mrekulli, unë nuk e di ç'të them. Unë filloj të kërkoj se mos gjej disa nga kryetarët e fshatrave, që të vazhdoj debatin e fillur me ta një ditë para pavarësisë së Kosovës, por nuk dalloj asnjërin prej tyre. Ferdini thotë se secili mund të bëjë zgjidhjen e tij dhe, nëse fshatarët e Buçimasit apo të Peshkëpisë kanë zgjedhur ruajtjen e pyllit, pasi duan ta bëjnë më të bukur fshatin e tyre, këtu ka më tepër rëndësi mishi e bulmeti, kështu që Picari ka zgjedhur përdorimin e shijimit e të mirave të natyrës së tij, por mua nuk më duket dhe aq bindëse, kur mendoj se ne shqiptarët nuk mund të mbetemi përjetësisht skllever të asj që na fal natyra. Përqipem të argumentoj, se natyra e Picarit duhet ndihmuar dhe ndihma mund të vijë duke i punuar tokat bujqësore, prodhuar jonxhë e koncentre, si dhe duke kombinuar atë që na ofron natyra me atë që arrihet me punë, djersë e investime. Dikush argumenton se në Picar mungojnë pothuaj tërësisht kanalet ujtë dhe kjo është arsyeja që asnjë metër katror tokë e Picarit nuk kultivohet.

Këshilli i komunës mund të vendosë për tarifa të diferencuara, sipas numrit të krerëve

E rëndësishme, thotë Lenarti, është se njerëzit kanë filluar të mendojnë në Picar. Plani i menaxhimit po hartohet, duhen llogaritur gjithë këto të ardhura, mbi njëqindmijë dollarë, që do të futen çdo vit në komunë, të ardhura që më përpara i merrte shteti, tani janë të komunës. Do të duhet të përgatitet sistemi i kontratave me të gjithë fermerët. Këshilli i komunës, përpara se të marrë vendime, lypset të konsultohet si me specialistët edhe me fermerët, për të marrë vendime të drejta për zhvillimin e zonës. Ndoshta, ndërhyr një fermer, ne mund t'i përdorim tani një pjesë të të ardhurave nga kullotat edhe për të riparuar kanalet ujtë e për të prodhuar foragjere apo misër. Koncentrimi mund të lehtësojë presionin mbi kullotën e kështu hap pas hapi edhe ne mund ta ndalojmë degradimin. Ndoshta mund të mendojmë edhe për taksë më të larta për tufat e medha, si dhe të ndihmojmë pak të varfërit, që kanë më pak dele e përdorin me pak se sa u takon nga kullota e përbashkët ...

Syrit të kaltër "po i kthehet shikimi" ...

Në buzëmbërme, ndërsa i afrohem Sarandës, dikush propozon një ndalesë tek Syri i kaltër, një mrekulli e fshehur nën rrezën jugore të Qafës së Muzinës. Syri i kaltër pësoi një aksident të rëndë në shirat e rrëmbyera të gushtit të vitit 2002, pak ditë pasi kryeministrat e atëhershëm italian e shqiptar, thotë ish drejtori i ujërave të Sarandës, kishin bërë një vizitë, për të parë nga afër mundësinë e transferimit të ujërave të Bistricës drejt Italisë se jugut. Në një vizitë në shtetin Montana të Amerikës, rreth 11 vjet më parë, kisha shpjeguar që edhe Shqipëria ka burime të bukura dhe ndër më të bukurit është "Syri i kaltër" në jug të vendit. Kjo është interesante më tha një nga profesorët e Universitetit të atij shteti, po çfarë e bën Shqipëria ujin e atij burimi, pyeti ai? E derdh shpejt e shpejt në detin Jon, pasi ve në lëvizje një HC në afërsi të burimit, përpjekja t'i argumentojta unë, ndërsa ai shpejtoi të më kujtojë etjen e dy vendeve fqinje, Italisë se Jugut e Greqisë. Siç duket, më shkëputi nga mendimet ish-drejtori i ujërave të vitit 2002, aktualisht drejtor i pyjeve të Sarandës, ndonjë "sy i keq" e sëmuri dhe tepër rëndë Syrin e Kaltër, dhe ai shpjegoi më pas përpjekjet që bëri drejtorja e ujërave për t'i kthyer ujin dhe shikimin Syrit të kaltër. Ai ka përsëri pothuaj prurjen e mëparshme të ujit, rreth 6000 l në sekondë. Lenarti e Bobi ngjiten në një fron të ndërtaur në pjesën e sipërme, për të parë "beben" e syrit. Uji del nga poshtë në formën e një pusi të thellë, me përmasat e një lumi të vërtetë, një rrymë jashtëzakonisht e madhe me ujë të tejdukshëm, nuanca blu në të blertë e të cilit vjen nga qielli, bimët anash apo dritë-hijet e bimëve, shpatit e pareteve anësore të burimit. Ish-drejtori shpjegon se temperatura e tij pothuaj nuk ka luhate gjatë vitit, si në stinën e ngrohët edhe në atë të ftohtë ajo qëndron ndërmjet 11-13°C.

Syri i kaltër ka plot "vëllezër" shpjegojnë me krenari sarandiotët, janë mbi 20 të tillë, që përbëjnë burimin e Bistricës. Ka mundësi, hamendësojnë ata, që zanafilla e tyre të jetë një liqen shumë i madh nëntokësor, që mund të shërbejë si furnizues i përhershëm e i rregullt i të gjitha burimeve të Bistricës. Ndoshta, ndërhyr Duro Alushi, inxhinier hidroteknik me përvojë mbi 30 vjeçare, këto ujëra mund të përbëjnë drenimin kryesor të krejt masivit karstik të malit të Gjërë



dhe të pellgut hidrogeologjik të fushës së Drinos. Sigurisht që këto janë hamendje, por nëse i referohemi logjikës, nuk mundet që prurjet e burimeve të Bistricës, prej rreth 18 mijë litër në sekondë, të sigurohen në sipërfaqen e vogël që i takon mikrobazën që e ushqen me ujë, pra pellgu i saj hidrogeologjik duhet të jetë më i madh se sa mikrobazën që sigurisht i dhuron ujërat e tij, në fakt burimet e Bistricës gjenden 45 m nën nivelin e luginës së Drinos, çfarë të bën të mendosh se ato mbledhin edhe ujërat e masivit të Malit të Gjërë apo të Luginës së Drinos.

Mbrëmja po afron, thotë drejtor Nehati, prandaj mendoj ta vazhdojmë në makinë shpjegimin dhe të përqipemi të arrijmë përfundimin e plotë të diellit në kalanë e Lëkursit.

Në Rivierën shqiptare

Alisteri, Skocezi i sapoardhur si konsulent për pyjet tek SNV, Roberti e Carli, ngrihen herët në mëngjes, për të bërë një vizitë të shkurtër në Butrint, duke përdorur si udhërrëfyes Carlin, ekspert suedez, që punon për Bankën Botërore në Tiranë dhe është pothuaj i shtëpisë në Butrint, pasi përveç projektit tonë ai kontribuon herë pas herë për projektin e menaxhimit të bregdetit.

Një natë më parë kishim bërë një kalim të shkurtër nëpër Sarandë, e cila Lenartit i dukej si një qytet tjetër. Jam i sigurtë se ime shoqe nuk do të pranonte se kjo është Sarandam kur të shohë fotografitë. Mbushur me shumëkatëshe të dendura, ajo nuk ka asgjë të përbashkët me Sarandën e vitit 1992, që Lenarti e ka vizituar për herë të parë. Në portin e vogël të qytetit një vapor gjerman ka sjellë dërrasa suedeze. Kamionë të mëdhenj vazhdojnë të ngarkohen në mesnatë e t'i nisnin dërrasat e holla për në Gjirrokastër. Edhe në fermën time private pyjore realizoj të tilla prodhime thotë Lenarti, këto ndoshta janë të ndonjërit prej komshinjve të mij. Sikur të ruheshin e mirëadministroheshin pyjet, ndoshta Shqipëria megjithë këtë sipërfaqe të madhe pyjore, edhe mund të eksportonte. Me gjithë këta lisa të bukur që kanë filluar të rrisin fermerët tanë, unë endërroj që Shqipëria për 10 vitet e ardhshme të bëhet faktor për të prodhuar fuçi lisi si për verën franceze ashtu edhe për uiskin skocez.

Një plan për të menaxhuar kullotat e Lukovës

Me synimin për të arritur në orën nëntë të mëngjesit në Lukovë, ekspertët e huaj duan edhe të shfrytëzojnë rastin për të parë bregun e poshtëm të Jonit. Në fakt, shpjegon gjithë emocione Liljana, inxhinierë me përvojë, që po harton planin

e menaxhimit për pyjet e kullotat, që ka marrë në pronësi komuna e Lukovës, bregu është i gjatë, midis detit Jon dhe këmbëve perëndimore të malit të Çikës, vijuar më këndej me vargun Konjak - Lavan, në fakt bregu fillon tek përroi i bardhë e mbaron në malin e Shëndëllisë dhe Liljana përqipet ta tregojë edhe në hartën topografikë që do ta përdorë për të vendosur kufijte e pyjeve dhe kullotave që qeveria u ka dhënë në pronësi fshatrave të komunës Lukovë. Sofoja, ekspert vendas për kullotat, pyet se si do të bëhet për Kakomenë, tani që pylli e kullota është pronë e fshatit, por ne përqipemi ta mbyllim debatin dhe Liljana shpjegon se bregu përbehet nga ai i sipërm, që përfshin pak a shumë Bashkinë e Himarës dhe nga i poshtëmi, që përfshin nga Nivicë-Bubari deri në Borsh, pothuaj tërë komunën e Lukovës. Bregu mund të themi se është një pasuri e mrekullueshme e Shqipërisë, si nga njerëzit, trashëgimia etnografike e kulturore, klima e toka, bimët e kafshët, hidrografia e peizazhi. Relievi i bregut të poshtëm, për ku ne jemi drejtuar, është më i butë, që reflektohet edhe tek njerëzit, bimët e jetesa. Por, krahas mrekullive të peizazhit midis detit të kristaltë e të pamatë dhe maleve shkmbore edhe degradimi i bimësisë, erozioni e zjarret mbeten problem, dhe Liljana më nxit të paraqes në projektor jo vetëm bukuritë, që ka filmuar nga helikopteri Jamarbëri, por edhe pamjet nga rrëshqitjet masive në Borsh e Lukovë.

Vija bregdetare e Bregut ndërhyr Feruzi, pjesëtar i firmës konsulente, është në total rreth 90 km e gjatë, me gjarpërimet e saj ajo është me e bukura e Jonit, me kontraste, plot gjire të vegjël e kepa shkëmborë, mjaft abrazive, e lartë, e thepisur. Nga gryka e përroit të Borshit deri në atë të Hundëcovës, gërryerjet e shpateve kanë krijuar kone gjigande me mbushjet që i sjellin përrrenjte torencale, nga kullotat dhe shkurret e degraduara në shpate. Unë përqipem të zgjedh midis pamjeve të shumta, duke ndryshuar vazhdimisht disqet, për të ilustruar nëpërmjet pamjeve e dhënë në kohë sa më të shkurtër kompleksitetin e problemeve, që vijnë si pasojë e mbikullotjes, zjarreve, brishtësisë së ekosistemit dhe tekave të tokës, ujit, ajrit e diellit.

Deti i ngrohtë jonian dhe vargmalet që e ndajnë nga pjesa e brendshme e vendit krijojnë një klimë tipike mesdhetare, me vegetacion sikur i afroresh tropikut, me temperaturë mesatare të shkurtit mbi 10°C. Siç duket kjo ngrohtësi krijon edhe degradimin, ndërhyr Roberti, që tashme është kthyer nga Butrinti, pasi delet, dhitë e lopët qëndrojnë e kullosin çdo ditë të vitit, nga njëherë edhe një orë që të rriten. Dhe kjo që përpara Odisesë, apo Qezarit, ndërhyr me shaka Samiu, ekspert i kullotave në Projekt. Relievi dhe klima i

kanë krijuar mundësi këtij rajoni që bimët të mund të rriten në të 365 ditët e vitit. Edhe reshjet nuk kanë të reshtur e kjo vjen nga fakti, thotë Mevlani, drejtues i grupit konsulent, që në ekip ka edhe të birin, që erërat e lagështa perëndimore përplasen mbi shpatet e maleve, ku avujt në Lukovë shndërrohen në mbi 1370 mm shi, të cilat bien mbi 80 % gjatë vjeshtës e dimrit dhe me intensitet ndonjëherë edhe 300 mm në 24 orë.

Nënkryetar i komunës, inxhinier ndërtimi, por që ia di huqet e vlerat vendit të tij, me logjikë e optimizëm për të ardhmen e Lukovës, tregon për burimet e pasura ujore, sidomos në kontaktet e formacioneve gëlqerore me ato terrigjene, burimet janë të pasura e të bukura veçanërisht ato të Borshit, që kalojnë në lokal (Izvori), apo Sopotit i Borshit, të Bunecit e Lukovës, të cilët ndikojnë që të qëndrojnë e gjelbër pjesa e poshtme e bregut.

Agavia, kryetare e gjëmbeçëve të Jugut

Makja mesdhetare, thotë Liljana, këtu është e pasur në lloje dhe në vendet me lagështi është e harlisur, plot me xinë, mare, mersinë, shqopë, mretë e oleandër, dafinë e gjineshter, ashe e ilqe. Të rralla për Shqipërinë janë xhixhibanozi e pambuku i eger, por më i veçanti është rryelli, që është ndoshta i vetmi dru në shqipëri që vegjeton në dimër dhe rrezon gjethet në verë. Po ashtu fiku i detit. Edhe banania, që dikur bënte vetëm lule, ndoshta edhe nga ngrohja globale, ka filluar ta rrisë më tepër frutin. Limoni, portokalli e ulliri ndjehen më tepër se në shtëpi, pasi janë realisht më të mirët.

Valanidhi është simboli dhe krenaria e Bregut. Po shtohet me shpejtësi selvia, thotë Ervini, më i riu në ekip, ndërsa Jani shton me shaka se ndoshta është i vetmi lloj pyjor që dhite nuk e pëlqejnë e, për pasojë, nuk “ia presin” kokën. Ja, kemi e po na shtohet edhe agavia, thotë një fermer nga Sasaj, që na e kanë sjellë nuk e di se nga ku, sikur të mos na mjaftonin gjëmbeçët tanë, por e di unë, zjarrin do ajo, kam frikë se po na heq valanidhin e ilqen tonë, nëse do ta lemë, lëre barin se e zhdruk për fare. Në disa shpatë të duket sikur të jesh në shkretirat e mëdha e jo në bregun e ngushtë e të vogël të Jonit, që edhe pa Agavet ndjehet mjaft i ngushtë për të mbajtur bimët, njerëzit e kafshët ... Robertit i kujtohet debati për gjëmbeçët në kullotat e Picarit dhe këshilla për të grumbulluar sa më shumë gomerë për t'i ngrënë e rivendosur ekuilibrin në kullota. Edhe shkurreve me gjemba ndoshta mund t'u gjendet ilaci, duke i vënë nga pas e mos ia ndarë një tufë me dhi, por ç'ti bësh agaves, që e kane sjellë njerëzit? Pikërisht në këtë ekosistem brilant, që të ngjan sikur je në këthizën e botës. Bregdeti i kërkuar nga gjithë perandoritë e perandorët e botës, nga grekët, romakët, venecianët, turqit, rusët ..., djepi i legjendave, zotave e perëndive të vjetra sa bota. Të banosh e të menaxhosh këtë ekosistem, sa të bukur e me thesare, aq të brishtë e idhnak, të kërkuar, e që do vizitohet nga pretendentë të rinj e të vjetër, kërkon dije e përgjegjësi, kërkon t'i njohësh e kapërcesh udhëzuesit e rregulloret, të kesh njohje mbi çdo gjë të përparuar në vende të ngjashme e të synosh largimin nga mbështetja vetëm tek ajo që natyra ofron, të mbështeten njerëzit e ditur e të hapen shkolla për të mësuar se si duhet të bashkëpveprojnë banorët e Bregut ne mjedisin rreth tyre, me këtë perlë të mesdheut, të bëhen koshientë, që ata jetojnë në një mjedis delikat, që në asnjë mënyrë nuk mund të jetë vetëm kullotë, që digjet periodikisht e që të gjithë deri dje kanë luajtur si struci, pasi nuk dihej kush ishte pronari, përdoruesit apo perfituesit, e zjarri zgjidhej si me e lehta zgjidhje ...

Në fillim të mbledhjes, Nehati njofton se sipërfaqja që KM i ka dhënë në pronësi Lukovës është mbi 6000 ha; debati vazhdon për rregullimin me kontrata të marrëdhënive me fermerët, si brenda e jashtë Lukovës. Prioriteti ynë është turizmi, thotë nënkryetari i Komunës, ndërsa peizazhi, blegtoia dhe uji e pemët janë shtyllat kryesore të tij. Ndoshta edhe përpunimi, si dhe rekalmi e produkteve blegtoiale të kullotës së Lukovës mund të bëhen faktorë për shtimin e vlerës, ashtu si është bërë për vajin e ullirit. Rrugës

për në Borsh dëgjohej një gurgullimë e madhe uji. Janë dallgët, them unë, por Sofoja nga Çorraj tregon daljen e tunelit të hapur ndoshta tridhjetë vjet më parë, që e sjell ujin nëpërmjet tunelit 734 m të gjatë, që çau malin nga Tatzati e rrembeu gjithë lumin e Kalasës në fshatin Tatzat, për ta shpërndarë nga Qafa e gjashtës e deri në Borsh, për të ujitur agrumet e Lukoves.

Roberti ngul këmbë, që përpara se të pranohen ndërhyrjet e propozuara nga Projekti e të financohen ata, duhet bërë një analizë ekonomike, për leverdinë të themi të ndërtimit të lerës, shkulljes së barërave të këqija apo plehërimit të kullotës. Prenga ndërhyrjen se ka vite që kërkohet por në fakt pothuaj asnjëherë nuk bëhet. Tirana ka mbajtur përsëri shumë nga kullotat tona, megjithëse neve ato nuk na teprojnë, thotë një nga banorët e Harko, nga Holanda, pyet nëse shteti vazhdon të mbarështojë blegtoia e të mbajë tufa e nëse jo përse duhet të mbajë në pronësi kullota, pasi kullotat duhet t'i mbajnë e të mësojnë t'i menaxhojnë ata që mbarështojnë blegtoirinë.

Nisemi drejt luginës së Borshit, për t'iu drejtuar qafës së dërrasës, që e ndan Kuçin nga Bregu. Ngjitemi drejt Çorres e provojmë të shohim edhe njëherë Bregun plot me shkëmbenj, me zallin e depozituar, që ka formuar plazhet mahnitëse të Borshit, Jalës, Gjipese e Lukovës. Plazhe si margaritarë të vegjël, si foleza të një bregu plot kepa, gjire e gremina. Pasqyra e Jonit reflekton hera pas herë diellin shpateve të Fterës e Çores, uji i tij i kaltër e i thellë, pothuaj i tejdrukshëm, është në mëdyshje për diellin, t'ia dërgojë rrezet në fund të tij apo t'u japë edhe një dorë shpateve. Bregu është një parajsë. Ka bukuri e pasuri. Bregu, Delvina, gjithë fushat, fushëzat përreth, malet, luginat e kodrinat, që të bëhen më të bukura, duhen trajtuar së bashku, që secili të luajë rolin e tij, si deti, mali, fusha e të gjithë së bashku t'i shërbejnë njeri-tjetrit për misrin, grurin, peshkun, gjethin, barin e secila të shfrytëzohet me masë.

Këmborët e Kuçit bien në Stokholm

Rrugën e vjetër drejt qafës së dërrasës e kisha bërë disa herë në vitin 1985, ndërsa studiohej mundësia për t'u zgjeruar masivi me agrume i Lukovës, ndërsa Sofoja na thotë të futemi në rrugën e re nëpër luginë drejt fshatit Çorre, pasi rruga është më e mirë dhe e shkurtër. Sofoja na kujton se ndodhemi në grykën e Bodarit, një kanion shumë i thellë midis kodrës së Sopotit (Kalaja e Borshit) dhe skajit jugor të Vakajve, me thellësi rreth 300 m. Makinat sikur zvarriten rrugës me gropa, në fundin e luginës së rrethuar nga malet e Gjeshnikoshit e Galishtit në lindje dhe atij të vakajve në perëndim, në një gjatësi prej 15 km, dhe në qafën e dërrasës në lartësinë rreth 640 m ndahemi nga Bregu për t'u futur në malësitë e Kuçit, që i mbedhin ujërat në luginën e Shushicës, e dyta pas Drinos, që ushqejnë lumin e Vjosës. Lujina sikur ndan nga lindja malësinë e Kurveleshit, që i jemi afruar shtëpërimi në Tepelenë, me vargun malor të Çikë - Lungarës një mur që e pengon Luginën e Shushicës të shohë e përfitojë nga avantazhet që mund t'i jepte deti Jon. Në krah të buronjave, burimet kryesore që ushqejnë lumin e Vlorës, është vendosur fshati Kuç, ku ndalemi për të provuar pritjen dhe traditat në gatim të kuçiotëve.

Lokali i befason vizitorët, jo vetëm për gatimin e mrekullueshëm të qëngjit në hell, por edhe për organizimin tepër të veçantë të lokalit, një nga të shumtët në qendrën modeste të fshatit. Lokali ishte edhe banak e dyqan për fshatin e njekohësisht një muze i vogël, po shumë i pasur, me hartën e Shqipërisë e të Kuçit në oxhak, me rakinë e zverdhur, duke u fërkuar me paretet aromëkëndshme të fuçisë shumë të bukur prej dru lisi, më këmborët, zilet, veshjet e ornamentet e kuzhinës, të vendosura me shumë shije në fund të lokalit. Arsistelit skocez, voza e lisit i kujton traditën e vendit të tij për prodhimin e uiskit, ku kushti kryesor është që alkooli të rrijë me aromën e drurit të dushkut, ndërsa bulmti sikur kishte akumuluar më të mirën e luleve dhe aromva të kullotave të maleve.

Lenarti kërkon me ndrojtje të blejë për ta dërguar ne Suedi, këmborën e madhe më një tingull të veçantë, simbol të tufave të mëdha me të imëta të Kuçit e Labërisë, të cilën kërkon t'ia bashkojë dashit të bukur të Buticit, ndërsa shumë të tjerë blenë nga një mostër të “Wiskit” të Kuçit.

Horë – Vranishti, shkollë për pyjet e kullotat komunale në Labëri

Kemi kërkuar të marrim 19 mijë hektarë pyje e kullota, që ndodhen në kufijtë tanë administrativë, thotë kryetarja e komunës, pas mirëseardhjes në Horë-Vranisht, por deri tani na janë ligjësuar vetëm ata që kishim planin e mbarështimit, që patëm bërë me mbështetjen e projektit të parë të Bankës Botërore. Nëse na jepet gjithë sipërfaqja, vazhdon ajo, ndoshta mund të shmanget edhe degradimi nga mbikullotja, pasi Horë-Vranishti nuk ka më shumë se 20 mijë të imëta dhe vitet e fundit kemi bërë punë intensive me fermerët, për të gjallëruar bimësinë tejet të degraduar të pyjeve e kullotave në krahinën tonë.

Relievi i veçantë ndikon edhe për një klimë speciale në gjithë krahinën e Lumit të Vlorës, ku temperatura mesatare vjetore shkon rreth 14.5°C, ndërsa reshjet arrijnë deri në 2400 mm në vit. Luginës i qëndron mbi krye si ombrelë mali i Çikës, 2045 m apo më i larti i Bregut, që qëndron si një far i lartë për detin Jon dhe si strehë verore për delet e blegtorët e Lumit të Vlorës. Qafa e Shëngjergjit, rreth 800 m poshtë majës, duket si e vetmja portë natyrore për t'u lidhur me Dukatin e Bregun. Një tunel në atë drejtim do t'i shtonte frymemarrjen Lumit të Vlorës, por edhe Bregut do t'i ulte presionin njerëzor e do ta bënte më atraktiv, pasi do t'i shtonte krahas detit edhe malin e nje peizazh e traditë të papërsëritshme jetësore çdo vizitori. Mendja me vete tek thënia e Fatosit të Sida-s, se sa e vogël do të na duket Shqipëria, kur të bëhet me rrugë të rregullta, sa afër do duket Tërbaçi më Dukatin, Dhërmiun, Pilurin apo Himarën. Unë hamendësoj se si do të dukeshin malet e Lbabërisë të veshura me pyje, më të mëdhenj apo ...

Vitet e fundit përroi i Kaurit pranë Tërbaçit apo ai i Vranishtit, që derdhen në Shushicë, sikur kanë filluar të bëhen më të qetë. Bari, shkurret e drurët po i mbushin gradualisht shpatet e anës tonë, thotë kryetarja, kjo edhe falë punës me komunitetin e bindjes se pylli e kullota janë mbështetja kryesore për jetën e përditshme të fermerit. Por, përrrenjtë perëndimorë bëhen çdo vit e më agresivë. Përrrenjtë zbresin në terrene tektonike shumë të pjerrëta. Ata janë të shpeshë e agresivë, duke e prerë shpesh e shpesh malin që nga maja deri në det, që nga përroi i Gërzhinës, Dukatit, i rrugëve të bardha, i Dhërmiut, Ngjipësë, Vishës, Spiles e të tjerë, që tërë vitin duken të thatë e të shkretë e në kohë shirash çajnë thellë shpatet shkëmbore, duke përciellë në vend të turbullirës gurë e shkëmbenj drejt rrugëve, fshatrave e detit, me shtretër të mbushur plot me gurë të mëdhenj

nganjëherë disa tonësh. Shkatërrojnë rrugë, kullota e ara, por ndonjëherë krijojnë edhe plazhe zallore.

Urën e Tërbaçit e kalojmë me frikë, pasi duket si e sajuar mbi disa shina, ku pllakat metalike rrëshqasin lirish e gommat sikur do depertojnë për t'i përciellë makinat në hone pabesueshmërisht të thellë, krijuar nga përroi karstik. Përballë, në anën tjetër, ka mbetur i papërfunduar pallati i kulturës i Tërbaçit, nisur që para viteve '90, që dikush me shaka thotë se mund ta kthejmë në një dyqan relikesh, pse jo edhe këmborësh e zilësh për turistë “tekanjozë”.

Pylli i Tërbaçit është kthyer në “livadh” me bimësi plot shëndet e kryetarja ndjehet më krenare se sa me qenë nga Kuçi, kur tregon se banoret e komunës së saj janë të zotë ta mbajnë fjalën e ta zbukurojnë Tërbaçin e gjithë Horë-Vranishtin.

Robeti pyet se çfarë është bërë, dhe Fori, inxhinieri që e ka asistuar shoqatën, bashkë me Abdylin, pika fokale e Projektit për Vlorën, shpjegojnë, teknologjinë e zbatuar, duke prerë rrafsh të gjitha shkurret e dushkur, të kullotura për vite, nga dhite e delet, të deformuara, ku rrugët e transportimit të ushqimit nga toka në gjethe i kane bllokuar, gungat e kthesat e tepërta. Filizat e rinj duken të shëndetshme e premtues. Nëse Horë-Vranishti do të vazhdojë në rrugën e nisur, duke llogaritur kapacitetin e kullotës, hartuar kalendarin e kullotjes për çdo vend, diferencuar tarifat, duke taksuar më tepër ata që kanë tufa të mëdha e i përdorin për fitime e shitje, ndërsa duke i stimuluar fshatarët e varfër, që kanë pak tokë bujqësore, që te mbajnë më shumë dele, dhi e lopë, duke paguar tarifa më të ulëta, por duke gjetur edhe mënyra për të shtuar gjahun, si thëllëzën, pëllumbin, fazanin, lepurin etj., Lumi i Vlorës mund të bëhet shkollë për gjithë komunat e bashkitë e bregut të detit Jon dhe po kështu për gjithë Labërinë.

Dhënia në pronësi e pyjeve dhe kullotave, fshatrave e komunave, krijon mundësi të gjera për të zgjuar traditën dhe mëndjen e njerëzve, që fermerët të kërkojnë krahas kthimit në traditë, edhe dijen, për të përfutur në maksimum nga përvojat më të mira të botës së zhvilluar, duke hapur shkollat si për kullotjen edhe përpunimin e mishit e të bulmetit, bimëve mjekësore apo shtimit e përfutimit nga gjahu e turizmi.

Misioni i Bankës dhe Ministri i Mjedisit ishin pothuaj në një mëndje që numri i komunave që mbështeten nga Projekti në Jug duhen shtuar, duke futur të parën në listë atë të Zagorisë, me kryetare Anastasinë, konkurente e kryetares së Horë-Vranishtit e duke vazhduar me Kurveleshin, Pogonin, Luftinjën, Xarën, Dropullin, Livadhjanë e Orikumin. Duket se peizazhi i maleve te zhveshur të Jugut do të fillojë një ndryshim të ngadaltë, po të qëndrueshëm, banorët do të mësojnë ta përdorin më mirë e ta kthejnë në parajsë të vërtetë me bar e pemë, plot me gjah e turistë, ku erozioni të kujtohet si dukuri e dikurshme.



Vendim i Këshillit të Ministrave

Nr. 396, dt. 21.06.2006

PËR KRITERET E TRANSFERIMIT DHE TË PËRDORIMIT TË PYJEVE NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Ne mbështetje të nenit 100 të kushtetutes dhe të pikës 7 të nenit 23, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave,

Vendosi:

- Njesite e qeverisjes vendore, për marrjen, në pronesi ose në përdorim, të pyjeve, prona publike të paluajtshme të shtetit, paraqesin kërkesën sipas procedurave të percaktuara në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore".
- Kërkesa shoqërohet me dokumente ku përcaktohen:
 - përshkrimi teknik i pyllit, përfshirë raportin ndërmjet pyjeve të larta, trungishteve, cungishteve e shkurreve, infrastrukturen perkatese dhe largesine e tij nga fshtarat;
 - vendodhja e pyllit, e pasqyruar në hartat perkatese;
 - vertetimi, që pylli i kërkuar nuk është në pronesi private.
- Njesive të qeverisjes vendore, u jepen në përdorim apo në pronesi, sipërfaqet pyjore, mbështetur në keto kritere:
 - Sipërfaqja pyjore të jete në territorin e komunes;
 - Sipërfaqja që kërkohej, të kete kufij të qarte ndares me pyjet, prone shtetërore, me pyjet e komunave kufitare dhe me pyjet prone private;
 - Pylli i marre, në pronesi apo në përdorim, të shërbejë për përmirësimin e gjendjes ekonomiko – sociale të fshatit / komunes, nëpërmjet rritjes së të ardhurave nga administrimi i kesaj pasurie;
 - Përdorimi i sipërfaqes pyjore të zbusë nevojatë domosdoshme për furnizimin e komunitetit me dru zjarri dhe për mbareshtrimin e blegtorisë;
 - Administrimi i pyjeve të mbështetet në traditën e komunitetit, që pasqyrohet në planin e menaxhimit;
 - Te garantojë zbatimin e kërkesave ligjore, si dhe të kritereve e standarteve për pyjet;
 - te realizojë menaxhim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të pyjeve, duke kryer investimet e parashikuara në planin e menaxhimit, me financimet e veta e donacionet.
- Njesia e qeverisjes vendore, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, për kalimin në pronesi, ben regjistrimin e sipërfaqes pyjore në zyren e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
- Pyjet e marra, në përdorim ose pronesi, quhen pyje komunale dhe përdoren nga njesite e qeverisjes vendore sipas kritereve të mëposhtme:
 - Respektimi i destinacionit dhe moszvogelimi i sipërfaqes së pyllit komunal;
 - Identifikimi i përdoruesve të pyjeve komunale në nivel përdoruesi, grup përdoruesish apo fshati dhe paisja e tyre me kartela përdorimi;
 - Ndihma për gritjen dhe funksionimin e shoqatave të përdoruesve të pyjeve, në përputhje me ligjet në fuqi;
 - Hartimi, miratimi dhe zbatimimi i planit të menaxhimit të pyjeve komunale, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Pyjeve dhe me kërkesën e parimit të zhvillimit të tyre të qëndrueshëm dhe në bashkëpunim me keto shoqata;
 - Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të komunitetit në përdorimin, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve komunale;
 - Bashkëpunimi me strukturat rajonale të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me shoqatat e pyjeve dhe ato mjedisore;
 - Krijimi i fondëve për investime dhe mirembajtje të ketyre sipërfaqeve pyjore, në baze të të ardhurave nga tarifatat e lëndës drusore, bimeve medicinale, gjuetisë, kullotjes dhe gjatës.
- Jo më pak se 70 për qind e fondit të krijuar sipas shkronjës "e" të pikës 5, të këtij vendimi, përdoret për përmirësimin e pyllit komunal.
- Strukturat rajonale të pyjeve në rrethet ofrojnë shërbim këshillimor për përdoruesit e pyjeve komunale.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kontrollon zbatimin e kërkesave ligjore në përdorim të pyjeve komunale.
- Kur një njesi e qeverisjes vendore nuk zbaton kriteret dhe kërkesat për përdorimin e pyllit komunal, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i Propozon këshillit të Ministrave shfuqizimin e se drejtes së përdorimit të tij.
- Rregullat e percaktuara në kete vendim zbatohen edhe kur njesite e qeverisjes vendore marrin, në përdorim ose në pronesi, kullota, prone publike të paluajtshme shtetërore.
- Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njesite e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MISIONI TEKNIK SUPERVIZUES I BB NË LIBRAZHD

nga FATMIR BRAZHDA

Misioni teknik i Bankes Botërore, pas vizitave në Veri e Jug të vendit, u zhvendos në Librazhd. Objektivi i misionit në komunat Qendër, Lunik e Steblevë ishte:

- Vlerësime për progresin e punimeve të realizuara nga projekti i pari i BB me 2001-2003.
- Problemet e evidentuara gjatë zhvillimit të ketyre projekteve.
- Efiçenca në natyrë e në komunitet (sa janë arritur objektivat e parashikuara dhe a shërben).
- Ecuria e projektit të dytë me miniprojektet e mbështetura me paketa financiare.
- A është treguar kujdes në menaxhimin e kullotave dhe çfarë duhet përmirësuar.
- Si e presin pjesëtarët e komunitetit transferimin e pyjeve në përdorim apo në pronesi.

Me keto objektiva, misioni shkoi së pari në Komunën e Qendrës (Librazhd), ku vizitoi disa sipërfaqe pyjesh komunale në Rrapun të fshatit Dorez, të cilat nga kujdesi e puna e pronarëve tradicionale janë zhvilluar mjaft mire.



Takim me Shoqatën "Luniku" Komuna Lunik



Takim me Shoqatën "Ylli i Alpeve", Komuna Stebleve

dhe u shprehur atyre siguri-garanci e mbështetje në realizimin e të gjitha projekteve që kanë si qëllim menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve e kullotave të Komunës.

Nga Luniku, rruga vazhdoi drejt Komunës Malore Stebleve, shoqëruar edhe nga drejtori i Shërbimit Pyjor të rrethit Ilmi Mysliu dhe Shefi i Menaxhimit, Inxh. Barjam Kullolli. Së pari u ndalën në pyjet e përmirësuar gjatë periudhës 2002-2003, ku tashmë janë arritur objektivat e parashikuara në projekt, madje nga ana teknike del që në keto sipërfaqe duhet aplikuar një tjetër ndërhyrje. Misioni vërejti me kujdes zhvillimin produktiv të ketyre projekteve, realizuar nga Shoqata "Ylli i Alpeve" dhe Komuna Stebleve, madje kjo shoqatë kishte përfunduar investime edhe nga projekti i dytë, që po ashtu ishin kryer me sukses dhe nga kjo ata ishin të gatshëm për realizimin e të gjitha projekteve të parashikuara në Planin e Menaxhimit 2007 - 2017. Drejtuesi i Shoqatës, Medi Çela dhe specialisti i Shoqatës, Inxh. Trifon Çfarku, ishin mjaft të angazhuar në zbatimin e miniprojekteve të mbështetura nga projekti i BB. Nisur nga puna e kryer deri tani, ata kishin "guximin" për të kërkuar lehtësimin e fondeve për realizimin e projekteve tjera. Kërkesa e tyre mbështetej fort edhe nga kryetari i Komunës, Xhevit Boriçi, i cili donte që komuna e tij të perfshihet në një projekt-pilot, sepse i shërbente shumë zhvillimit të turizmit, për të cilin tani kanë nisur edhe projekte të tjera turistike.

Pas një dite të gjatë pune, misioni i BB, pasi falenderoi komunitetin e kesaj zone për punën e bërë në përmirësimin e situatës së pyjeve e kullotave, u larguan me mendime mjaft të mira.

Vijon nga f. 1

Pyjet dhe kullotat tona sigurojnë një gamë të gjerë shërbimesh mjedisore, si kontrollin e erozionit, stabilizimin e furnizimit me ujë apo përmirësim të cilësisë së ujit, përmirësim të biodiversitetit kombëtar apo global, si dhe vendosjen e themeleve për një turizëm kulturor e mjedisor.

Misioni beson se Shërbimet e Pagueshme Mjedisore kanë një potencial të madh për Shqipërinë dhe sugjeron eksplorimin për mundësitë e zhvillimit të tij për disa basene ujëmbledhës apo për tërë vendin. Shembull me potencial të dukshëm është komuna e Fierzës, ku pagesat në bashkëpunim me Korporatën Shqiptare të Energjisë (KESH) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për të mbrojtur pyjet e për pasojë të frenohet erozioni në shpatet e pjerrëta të Fierzës, duke çuar në ulje të ndjeshme të kostos për ruajtjen me vepra antierozive të rrugës, si dhe të liqenit të Fierzës. Për këtë Misioni rekomandoi realizimin e punës së duhur analitike, me ndihmën e një eksperti që mund të kontraktohet, i cili mund të ndihmojë për të zhvilluar më mirë mekanizimin e pagesës së shërbimeve mjedisore për rrethanat shqiptare, bazuar në eksperiencën të njohura në botë.

REFORMA NË PYJE E KULLOTA LYPSET TË VAZHDOJË

REXHEP NDREU - Koordinator i Federatës së Pyjeve e Kullotave Komunale, Dibër

Qeveria ka marrë vendim për transferimin e mbi 700 mijë ha pyje e kullota në pronësi të komunave, por akoma menaxhimin e tyre e bën Ministria e Mjedisit.

- ❖ Mungojnë institucionet ligjore për këshillimin e monitorimin e pronarëve të rinj;
- ❖ Mungojnë strukturat e shërbimit dhe ato të menaxhimit për pronat;
- ❖ Mungojnë strukturat për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë dhe vetë ligjet, që duhen ndryshuar, deri sa kanë ndryshuar pronarët dhe menaxherët.

Qeveria mori vendimin për të mbështetur pyjet tona edhe me një buxhet prej 19.4 milionë dollarë, për një projekt zhvillimi të pyjeve komunale për 5 vjet. Ky projekt synon menaxhimin e burimeve natyrore, bazuar në komunitetet e 218 komunave. Kështu, qeveria arriti të shpejtojë procesin deri në transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të NjQV. Ky është një veprim që duhet përshëndetur, pasi për këtë Federatat e Pyjeve Komunale ka mbi 5 vjet që llobojnë.

Por, a është e mjaftueshme reforma, a duhet vazhduar apo lenë në rrugë? Për këtë Federatat u mblodhën e diskutuan në Tiranë e Tropojë me misionin e BB dhe Ministrinë e Mjedisit dhe paraqitën kërkesat për të ndryshuar sa më shpejt aktet ligjore e nënligjore, strukturat menaxhuese dhe strukturat e tjera, për të gjitha pronat, kur kanë ndryshuar pronarët. Propozimet janë të qarta:

1. Të fillojë menjëherë permiresimi i ligjit për burimet natyrore (pyje, kullota, gjueti, bimë mjekësore), sepse nuk pasqyron realitetet e reformave të kryera nga Qeveria.
2. Të rregullohet skema e punës institucionale e ligjore, që del nga boshllëqet e dukshme dhe paqartësitë e derisotme.
3. Të rriorganizohet Shërbimi Pyjor, për shkak të transferimit të tokës në NjQV.
4. Të krijohen strukturat e Shërbimit Këshillimor për pyjet e kullotat komunale, në nivel Qarku, në varësi të Drejtorisë së Politikave Pyjore.
5. Të organizohen struktura me funksione kontrolluese e monitoruese për pyjet komunale e ata privatë, për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të planeve dhe menaxhimin e pyjeve, kullotave e burimeve të tjera të transferuara.
6. Të krijohen shërbimet teknike e këshilluese për Shoqatat, Komunitat dhe fermerët që merren me menaxhimin e Burimeve Natyrore.
7. Të ndahen shërbimet e menaxhimit për të gjitha pronat dhe kontrolli i zbatimit të ligjit nga struktura të veçanta, të pavarura.
8. Shkallë-shkallë të përmirësohet Strategjia e Zhvillimit të Burimeve Natyrore.

Në kushtet e krijuara, jemi para një situatë kur Ministria duhet të vazhdojë të konsultohet në të gjitha nivelet, me pronarët e rinj e të vjetër, për të vazhduar me shpejtësi ndryshimet. Ne jemi të gatshëm e do të mbështesim këtë proces, duke kontribuar për bashkëpunim më të mirë. Shpresojmë që politika ka arritur pjekurinë që të stimulojë organizimin e institucionalizimin e Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve (Oponencën e saj).

Mendojmë se na duhen ligje që fokusohen në çështjet kryesore të fondit pyjor, në funksionet kryesore, në problemet e pronësisë e të përdorimit, në ndarjen e menaxhimit dhe kontrollit të ligjit, në decentralizimin e vërtetë dhe delegimin e kompetencave, me qëllim që të gjitha menaxhimet e detajuara të jenë në strukturat / organizimet e deleguara. Strukturat për pyjet e ndara sipas pronësisë e përdorimit, do të bëjnë më me përgjegjësi menaxhimin e tyre. Një strukturë qendrore pa konflikt interesi duhet të jetë për t'u përfshirë për zbatimin e ligjit, duke kontrolluar të gjitha pronat që ka DSHP, Komuna dhe Privati. Jemi të sigurtë që këto ndryshime do të ndikojnë shpejt në përmirësimin e menaxhimit të pyjeve.

Pylli në rrugën nga komuna tek fshati e përdoruesi

- rruga e vetme për të siguruar mirëpërdorimin e pasurive natyrore -

Takimet e organizuara në Qarkun e Dibërës nga komunat Ulëz e deri në Reç, dëshmojnë se

përgjithësisht në kujtesën e banorëve është ruajtur mjaft mirë e drejta e familjeve në përdorimin e pyllit dhe kullotës. Takimet e zhvilluara në nivel komune dhe në nivel fshati, kanë evidentuar disa dukuri, të cilat duhet të jenë në vëmendje jo vetëm të atyre që merren me pyjet, po dhe të vendim-marrësve, për të kuptuar se pronat jo vetëm kanë ZOT, por edhe se shume banorë u kanë dale në krahë atyre, për të mos i lenë ashtu si u shkretuan për vite me radhe. Mbi 70% e banorëve kanë gurë e kufij të qartë, të njohur nga të gjithë dhe kjo ka bere qe secili të përdorë pyllin e kullotën që i kanë lenë trashëgim të parët.

Për të parë sa i fortë është ky rregull i vendosur historikisht në këto krahina, gjatë vitit 2008 kemi marrë pjesë në disa këshilla komunash, kur ato kërkonin që pronat të transferohen në pronësi të komunave në Tomin, Kastriot, Zerqan, Ulëz, Xibër, etj. Banorët, jo vetëm kanë të qartë çfarë kërkojnë, por dhe po bejne perpjekje per te ndaluar edhe shfrytëzimin e pyjeve te larte, qe po demtohen me e pa leje shfrytëzimi. Në Xibër nuk jane sqaruar banoret nëse duhet dhe pse duhet shfrytëzuar pylli dhe ata jane mjaft te pakenaqur kur, sipas tyre, shfrytëzimi behet edhe ne pyje me vlera mbrojtese nga erozioni ne kuroren e fshatrave te rrezikuar, prandaj ata kane vendosur te mos lejojne prerjen e pyjeve qe i konsiderojne te tyret. Keshilltaret, qe jane dhe pronare pyjesh te vegjel, në Tomin, vetem pas tre here debatesh arriten te hartojne e miratojne kerkesen qe pronat (perfshi edhe pyjet e kullotat) te kalonin në pronesi te Komunes dhe në hapin tjetër te kalojne ne pronesi te privatit, me vendim të keshillit të Komunes, sipas vendimit dhe tradites shumëshekullore.

Përgjegjshmëria e komunës dhe e komuniteteve për menaxhimin e pyjeve

Të marrësh pronat e sidomos pasurinë më të çmuar për vendin, pyjet e kullotat, do të thotë të marrësh përgjegjësi mbi vete, angazhim e perkushtim. Janë për t'u përzgjedhur privatët (përdoruesit e pronarët) tradicionalë të pyjeve në rrethet e Veriut, që kanë dhene modele si duhet të ruhen e perdoren pyjet e kullotat. Shembulli i Kalasë së Dodës e Kalisit tregojnë se si duhen ruajtur e përdorur pronat me kujdes, për te sotmen dhe te ardhmen. Natyrisht, për te mesuar nga keta shembuj eshte mire t'i shohesh e t'i prekesh, sepse me gazeta pak njerëz i mesojne ose s'duan t'i besojne. Duhet pare nga afer se si fshataret marrin vendime, si kane bërë e respektuar "Tifaqet", sa roje kane vendosur, si i menaxhojne pyjet e kullotat, si vendosin per prerjen e kullotjen, si i perdorin te ardhurat dhe si i bëjnë shpenzimet dhe si funksionon komisioni i fshatit.

Këto dite takuam këshilla të fshatrave dhe drejtuesit kryesorë të Zerqanit, të cilët kishin marrë vendimin e KM për transferimin në pronësi të tyre të mbi 5000 ha pyje e kullota. Kryetari i Komunes, qe eshte dhe specialist pyjesh, shprehet optimist për te ndryshuar gjendjen. Une çdo dite, thote ai, kam filluar te ndjek nga afer demet që behen në zonat e largeta dhe do te ndaloj çdo lloj kondrabande edhe ne pyjet e lartë; po ashtu, do te kerkoj nga shteti qe te transferohen edhe siperfaqe te tjera sepse mendoj se ne kemi mundesi t'i mbrojmë e perdorim më mire dhe te perfitojmë me shume, per te rritur te ardhurat e banoreve. Per kete, krahas rojeve qe ndjekin punen, ne mbeshetjet te tyre çdo dite eshte dhe policia e shtetit, qe ndihmon per parandalimin e dëmeve.

Ndërsa kryetari i Keshillit të Komunes u shpreh: Une kam lexuar me kujdes ligjin dhe vendimet e Qeverise dhe mendoj se ligji nuk pershtatet me te drejtat e pronareve, qe po marrin pyjet, qe jane komunat e komunitetet e tyre. Ne nuk kemi te drejta sipas ligjit, sepse ne ligj njihet pronar Ministria e Mjedisit, prandaj kjo duhet ndryshuar, por dhe duhen deleguar edhe më shumë fonde nga shteti te komuna per menaxhimin e përdorimin e pyjeve. Sipas nesh, por bazuar edhe ne vendimin e Qeverise, ne po mbeshtesim e forcojmë Shoqaten e Përdoruesve te Pyjeve e Kullotave Komunale, duke bere zgjedhje

te reja. Shoqata do te jete nje hallke e rendesishme, jo vetem per pyjet e përdoruesve, qe banoret i kane marre sipas tradites, por te kujdeset, menaxhoje e mbroje edhe pyjet kolektive ne baze fshati e komune, qe ka me shume veshtersi.

Shoqata ka ne perberje te saj, krahas bordit, edhe nje pylltar, qe eshte teknik pyjesh me shume pervojë dhe qe punon me program te caktuar, mbi bazen e planit te menaxhimit per pyjet e kullotat, qe jane transferuar nga shteti te komuna dhe nga komuna te komunitetet.

Pal Qoku, kryetari i Komunes së Ulzës (inxhinier pyjesh) eshte mjaft optimist per vendimin qe ka marre Qeveria per transferimin e rreth 5000 ha pyjeve nga shteti ne pronesi te komunes. Une - thote ai, kam vendosur deri tani në pune një inxhinier pyjesh, qe do te merret konkretisht me menaxhimin e pyjeve, se bashku me përdoruesit dhe shoqaten e ngritur në nivel komune. Në territorin tone eshte ndaluar çdo demtim dhe kondrabanda në pyjet e larte. Mendoj se mund t'i kerkoj keshillit te Komunes te punesoj edhe disa specialistë qe aktualisht paguhen nga DSH P ne territorin e Komunes, po gjithmone duke i vleresuar ne aspektin e efektivitetit ne pune, per te mundesuar parandalimin e çdo demtimi.

Jane keta shembuj qe mendoj se duhet te njihen e perkrachen nga te gjitha keshillat e drejtuesit ne NjQV, per te hedhur hapa te guximshëm dhe per te garantuar nje menxhim me te mire te pyjeve dhe te ardhura me te medha.

Planet e menaxhimit dhe çertifikimi i përdoruesve

Këto detyra kane nje baze ligjore, qe eshte vendimi i KM nr. 396, si dhe termat e references, ku përdoruesit pajisen me kartela, veprim qe duhet te behet në çdo plan menaxhimi, duke percaktuar disa elemente bazë: Kërkesat e përdoruesve, kufijtë midis tyre, kushtet e përdorimit dhe forma e menaxhimit.

Bazuar dhe në përvojën e deritanishme, mendojmë qe hartuesit e planeve te menaxhimit të shtojne e te respektojne me shume kujdes disa elemente, qe lidhen me kartelat e përdoruesve, si numrin e druveve per fazat e zhvillimit dhe keshilla praktike per pyjet e fermerëve me shume funksione e moshë. Konsulentet qe bejne planet, perdorin akoma metodat klasike te specialistit te pyjeve ne veprimet dhe rekomandimet per pyllin dhe territorin.

Ne takimin e realizuar ne Arras per rritje kapacitetesh, me shoqaten, fermeret perseriten kerkesen që projekti te mbeshetese me punime permiresuese sherbelen. Faqja e Çidhnës, nje

siperfaqe me mbi 300 ha, para disa vitesh jepte mbi 2000 kv sherbelë, me çmim tregu rreth 150-200 lekë e me treg te garantuar, pra me leverdi te madhe për fermerët. Por, a eshte ne fokusin e punes së grupit të punes se çfare duhet te behet ne kete plantacion per ta çliruar nga bimet e tjera, si shkoza e lajthia, qe kanë arritur te hijezojnë e bllokoje zhvillimin normal te sherbeles. A jane bere planifikime per mbjellje sherbele ose krijimin e kushteve brenda rajonit.

Ne Diber ka mbi 2000 ha plantacione lajthi të egra dhe kur shikon planet, masat e planifikuara shkojne deri te mbrojtja per prodhim fruti. A eshte kjo e mjaftueshme per nje plan 10 vjeçar? A nuk ka masa te tjera ç'duhet bere me lajthinë (rrallime, ricungime apo veprime te tjera ose studime per mbjellje te reja, kur ne Qarkun e Dibres ka rreth 16 000 ha toka te boshatisura). Këtë munde të themi edhe per gështenjen, e cila ka nevojë per luftimin e kancerit, për shkallëzime e rrallime, pasi eshte e perzier me dushk ose dhe sherbime te tjera per te rritur prodhimin.

I permendem keta shembuj per te sjelle ne vemendjen e konsulenteve, qe hartojne plane se formulat klasike te nje specialisti pyjesh duhen harmonizuar me kerkesat e fshatareve, kur kemi te bejme me plane qe jane me vlera per njerezit per sherbime e prodhime, qe gjenerojne te ardhura dhe jo vetem te ardhura, nga produktet drusore, por dhe te tjera, qe njerezit kane nevojë çdo ditë.

Per çdo përdorues, kur merr pyjet ne përdorim, sipas planit, duhet te jene ne çertifikate ose në nje letër në doren e përdoruesit dhe kjo letër te jete nje plan per fermerin dhe nje pergjegjesi per përdorimin e menaxhimin e pyllit qe ka marre ne përdorim, sherbimet qe ai do t'i beje pyllit dhe te ardhurat qe krijon nga përdorimi.

Bazuar në diskutimet e debatet e zhvilluara per planet e menaxhimit, me keqardhje vërejmë se shpesh komunat tenderojne njerëz te papergjegjshem dhe "Firma" qe jo vetem nuk kane konsulencen e duhur per te hartuar nje plan menaxhimi, por ne shume raste perben konflikt me hartuesin e planet dhe monitoruesin (DSHP).

Kur debatohen hapat dhe termat e references per hartimin e planit te menaxhimit fillojne pretendimet e justifikimet se mungojne buxhetet per te hartuar planet, per te ndare pyjet sipas përdoruesve, per t'u konsultuar me përdoruesit per menyren e përdorimit te pyjeve, per pajisjen e përdoruesve me kartela përdorimi. A vlejne keto justifikime, kur ke termat e references dhe objektivat e projektit, kerkesat e shtetit per reforme dhe vendimin e Qeverise, por dhe per faktin se si hartues plani ke pranuar dhe ke firmosur një kontratë.

U nda nga jeta Inxhinier Nikoll Pali

Disa ditë më parë, papritur u nda nga jeta inxhinieri i pyjeve Nikoll Pali (Ndoi), duke lenë në pikëllim të thellë familjen, të afërmit, miqtë dhe kolegët.

Nikoll Pali u lind në vitin 1948, në fshatin Gojan të Pukës, ku mori edhe mësimet e para. Më pas shkoi në konviktin e Pukës, ku kreu me rezultate të shkëlqyera edhe arsimin e mesëm. I etur për shkollim, duke vlerësuar edhe nevojat e vendlindjes, ai shprehu dëshirën dhe në vitet 1968-1973, studioi në Fakultetin e Pyjeve, ku u diplomua inxhinier.

Me vull e pasion, me plot projekte e ide, nisi punë në një nga sektorët më të vështirë, inxhinier shfrytëzimi në ish-Ndërmarrjen e Sharrave, Fushë-Arrëz. Aty njihet nga afër me profesionin, me njerëzit. Ajo periudhë, ndonse e shkurtër, i shërbeu si fakultet i dytë. Hapja e Shkollës së Mesme Pyjore në Fushë-Arrëz, kërkonte staf pedagogjik të kualifikuar dhe, një prej specialistëve të përzgjedhur për mësimdhënie ishte Nikoll Pali. Edhe si mësues ai shfaqti aftësi të mira, por spikati edhe si veprimtar shoqëror, gjë që i shtyu drejtuesit e kohës t'i ngarkonin detyra të rëndësishme drejtuese. Karriera e Nikoll Palit kulmon në vitin 1992, kur në zgjedhjet e para pluraliste, zgjidhet nga pukjanet deputet i Kuvendit Popullor.

Pas një karriere të gjatë e të suksesshme politike, në mesin e viteve '90 Nikolla i kthehet profesionit të inxhinierit të pyjeve. Për mëse gjashtë vjet ai drejtoi Shërbimin Pyjor të Pukës. Vitin e fundit të jetës ishte drejtor i ujësjellësit të këtij qyteti.

Për këtë veprimtari mëse 35 vjeçare si specialist e drejtues, kujtohet nga bashkëmoshatarët e kolegët, nga të gjithë ata që e kanë njohur, si njeri i dashur e korrekt, modest e i sinqertë, kerkues e rezultativ në punë, një familjar shembullor.

Pa dyshim, Nikoll Pali do të mbetet një emër i nderuar në gjirin e pylltarëve pukjanë, por edhe në shkallë vendi, për vlerat njerëzore e profesionale që spikatën në jetën e tij.

Vdekja e prakohshme e Nikollës është humbje e madhe për familjen e të afërmit, është hidhërim e do t'u mungojë edhe kolegëve e bashkëpunëtorëve.

Selim Dini, Kostandin Dano, Kol Malaj, Preng Prenga, Mirash Lulashi, Haki Zoto, Gjin Filipi, Qamil Brahimi, Gjon Fierza, Petrit Deda, Lekë Delia, Tonin Ndreka ...



Në kuadër të historisë së pylltarisë shqiptare

LIGJI I PYJEVE DHE KULLOSAVE

nga NIHAT DRAGOTI

PJESË E V. Cktimi i sasis, caktimi i çmimit, mënyra e shitjes, punim, traspotimi i druvet, qi do të priten ndër pyje- Të kullonit e bagtise

Sipas artikujve të pjesës V për drurët që parashikohen për t'u prerë, në pyjet shtetërorë, zbatoheshin këto rregulla:

1) Mbi trup nja një metër mbi tokë do të veht numri renduer me një ngjyrë të qindrueshme;

2) Nji metër nalt tokës do të mbatet cirkonferenca e poshtme ase dhiametri i drunit pa lëvore, e naltësija do të mbatet deri m'at vend qi mund të punohet druni e në libër të posaçëm qi do të mbahet do të shenohet:

- Numri i pjesës në të cillën gjindet copa e pyllit;
- Numri renduer i drunit;
- Cirkonferenca e poshtme e naltësija e sejcillit dru;
- Metro kubi i pa punuem i çdo druni.

Sasia vjetore e druveve që do të priten nga pyjet për qymyr ose dru zjarri, çmoheshin e caktoheshin në bazë të kuintalëve që shënoheshin në regjister. Keto veprime duhet të kryheshin e të plotesoheshin nga nëpunësat (teknikët e pyjeve) gjatë periudhes gusht-shtator. Për t'u theksuar është fakti që drurët e parashikuar për t'u prerë në pyjet ne pronesi të Bashkive/Komunave nga fshataret për nevojat e tyre duhet të shënoheshin prej nëpunësit teknik të pyjeve, por nen kontrollin dhe vëzhgimin e pleqesise e të rojtareve të këtyre pyjeve. Po ashtu, sasia e druveve që do të priteshin nga pyjet apo korijet private, si nga ana e zotëruesve dhe nga blesit, si dhe vendi i prodhimit të qymyrit e druve të zjarrit, caktoheshin prej nëpunësit teknik.

Ne Artikullin 65 percaktoheshin rregulla mbi caktimin e çmimit. Çmimi i druve që do të priten nga pyjet e shtetit e do t'u shiten kërkuesve, caktohet sipas llojit e madhësisë së tyne, sipas largësisë së pyllit e çmimit që do të kenë në treg.

Drutë e pyjevet simbas llojit ndahen:

- 1) Drutë qi përdoren ndër zdruckthatarë (marangos) si arra, lisi, lajthija, frashni (frene), blini, (Olmo) etj.
- 2) Drutë qi përdoren për ndërtesa, si me th. pishë, kështejë, etj.
- 3) Druritë qi përdoren për disa mjeshtri (industri) e qi kan një naltësi të vogël, si shimshirë (bush), thanë etj.
- 4) Çdo lloj druni qi pritet e përdoret për zjarm e qymyr.

Volumi i druve i dy kategorive të para caktohet në kambë, në themel të metrokubit, kurse i dy të tjerave me peshim. Largësija e pyllit do të caktohet, në themel t'orëve të udhëtim të qiraxhive e tue marrë për bazë (punto di partenza) një skelë deti ose skelë të lumit, prej të cilës bahet eksportimi i përherëshëm i landës, ase ndonji stacion t'udhës së hekurit, gjytet a treg ku zakonisht shiten e blihen landë e artikujt e djegshëm (combustible). Ato pyje qi me udhëtim të qiraxhijvet mbajnë prej ktyne bazeve të përmenduna: 3 orë janë largësi I; 6 orë II; 10 orë III; 12 orë IV; n'ato qi mbajnë ma teper se 12 orë janë largësi V.

Çmimi i lendës së pergatitur prej druve te kategorisë së parë e te dytë caktoheshin duke marrë 14 % mbi vleften qe ka lenda në treg. Mbi kete baze caktohej vlefta e meterkubit të lendës së papunuar dhe në këmbë në pyll. Çmimi i lendës së kategorise së tretë dhe vetëm per drutë e zjarrit të kategorise së katërt, caktohej duke marrë 15 % të çmimit qe ka kjo lloj lende në treg, ndersa për qymyrin caktohej duke marrë katërfishin e çmimit qe ka në treg lenda prej së cilës pergatitet qymyri. Drutë qe do të priten për çdo vit caktoheshin e shenoheshin nga tekniket e pyjeve, ku per çdo dru vihët nje numer rendor dhe vula.

Çmimi i lendes se valanidhit, luleve të blinit, lëvoreve, katranit (peshkve), serës (zyfti) kur do të mblidhen apo do të përgatiten ne pyjet dhe kullotat e shtetit caktohej 15 % mbi vleften e prodhimit/shitjes në treg, pa marrë parasyh largësinë e vendit ku prodhohej; vlefte e cila caktonte çmimin qe kishte prodhimi në pyll a në kullotë.

Çmimet per kullotjen caktoheshin për çdo hektar kullote (dimerore e verore) si dhe për pyjet shtetërore, duke marrë parasysh gjendjen e posaçme të vendit dhe caktohej nje taksë kullote prej fr. Ari 1, 20-2 (grosh 6-10). Për rasatin e bagtise, që do të kullonin në vende të pandaluara (si ne pyjet e kullotat shtetërore), apo per kalimin nga nje zone në tjetren dhe jo per qëllim dimerimi ose verimi, u merrej nje taksë për cdo krenër dhene e dhi, fr. Ar 0,005 (pare) dhe për lopë, kuaj, etj., fr. Ari 0,015 (3 pare) në ditë. Taksa paguhej përpara se të futej bagtia në kullotë, duke u dhenë zoteruesve nje diftesë, ku caktoheshin edhe ditët sa do te qendronte bagetia ne ate vend. Ne raste nevojë do të kerkohej qe bagtia te qendronte me teper nga sa ishte caktuar, do të paguhej perseri taksa shtese e përditshme, shoqeruar me diftesen.

Edhe për lëndën drusore qe pritej e transportohej nga çdo lloj pylli a korije private, të bashkive/komunave ose për rastet e druveve të shperdare ne ara e toka bujqesore paguhej si taksë pyjore, per çdo metër kub lendë të papunueshme, 7 %, d.m.th merrej gjysma e çmimit të lendes se druve të pergatitura ne pyjet shtetërore. Për rastet kur lenda ishte e punuar merrej si taksë pyjore 7,5 % mbi vleften e lendes në treg. Për drutë e zjarrit dhe qymyrin, ne rfastet e tregtimit nga fshataret për nevojat e domosdoshme të qytetareve, nuk merrej taksë pyjore. Përjashtoj nga taksat lenda qe përdorej për godinat private. Për drutë e zjarrit dhe qymyrin qe pergatiteshin ne pyjet e korijet private, paguhej gjysma e taksës së caktuar për pyjet shtetërore.

Ne Kreun III percaktohej menyra e të blerit të druve, ne artikullin 79 (duke patur parasysh rendesine e ketij procesi, po i ribotojme nenet siç jane ne orgjinal), percaktohej:

- Drutë e pyjevet të Shtetit shiten në shpallje.
- Për të prem, të punuem e të qitun jashta pyllit të sasis së përvjetshme të drurvet të shitme, jepet zakonisht një vjetë afat.
- Shpallja fillon në Gusht e mbaron në fund të Shtatorit.

Drutë, qi janë shënjue për t'u pre do të rreshtohen në disa grumbuj, si mbas vendit, numrit të pjesës ku gjinden drutë, të cillat do të ken një cirkonferencë e naltësi të njëjtsigme, tue caktue për çdo grumbull numrin e druvet, volumin e papunuem,



çmimin e caktuem për çdo metrokub, e shumën e pergjithme të çmimit.

Shkresat e shpalljes, qi do të trajtohen me shënimet e naltpërmenduna e me numër renduer do të varen ndër vënde ku duhet të Qandravet e të Nenprefekturavet e të Krahinavët e të Bashkivet, në xhamija e kasha, e do të shtypen nder fletorët e vendit.

Mëndyra e shpalljes e shitjes së druvet të zjarrit e të qymyrit qi do të përgatitet nder copa të pyjevet, do të bahet tue shenjue në letër shpallje numrin e pjesëve të pyllit, kohën e të permitit e të qitunit jashta pyllit, sasin e çmueme e ql. (quintalve) të druvet të qymyriot qi do të bahet, çmimi i caktuem për sejcillen ql. dita e vendit ku do të bahet shitja.

Ata qi kerkojnë me marrë pjesë në të blemit e druve e tjera, për të cillat asht ba shpallja, lypset të paraqesin ase e të dorzojnë rregullisht një lutje nëpunësit ma të naltë t'Administratës së vendit ku do të bahet shitja në Kryeqytet në Ministrin e P.B. e Bulqesis me të cillen do të dishmojnë se drutë e nxjerruna n'ankand janë kenë pa e se di-ditën e fundit t'adjudikatës, kan me u gjetun në vend të caktuem të shitjes (në zyrën qeveritare qi asht shënjue në letër shpalljeje, tue prue me vedi 10% të çmimit të caktuem në letër adjudikatës, ase për kundrazë në rasë të mungesës do t'i shtrohet humbjes së drejtave kërkimi.

Kerkesa (Lutja) do të mbyllet më një zarf të vulosun në tre vende me dyllë të kuq, më një anë të cillat do t'i shkuhet "jam kërkues për drutë ase qymyrin etj, për të cillat asht ba shpallje".

Lutjet do të ruhen të mylluna prej nëpunësit e do të çilen prej dorës së lutsit ase t'atij qi i asht dhanë autorizimi i perfaqsimt me shkrim, ditën e fundit qi mbaron koha e shpalljes e n'orën e caktueme.

Diten e fundit të kohës së shpalljes n'orën 4 m.d. do të mblidhet një komisjon i përbaem prej dy antarëve të Këshillit Administratuer të vendi, prej nëpunësit ma të naltë të Financës e të Pyjevet, nën këyesin e nëpunësit ma të naltë të Administratës në kjoft se shitja bahet në Kryeqytet komisioni përbaem prej Ministrin P.B. e Bujqesis i cili mbane dhe Kryesin, e dy Kshiltarve teknikë edhe Kryesekretarit t'asaj Ministrie. Komisioni i formuem do të thërrasë lutsit, e sejcillit do t'i dorzojnë zarfin e mbyllun të lutjes së vet, të cillin mbasi t'a ken hapun me dorë të vet, me lutje mbrendë, do t'i a paraqesin Kryetarit të Komisionit.

Për në kjoft m'u ba se një shitje, atëherë formalitetet e përmenduna do të bahen veçanerisht për sejcillin e tue i u përmbajtë mbas numrit të rendit shenjue në letren e shpalljes.

Lutjet e paraqituna do të radhohen më një listë si mbas datës qi permbaje e mbassi sejcillit lutës të ken numrue te hollat e kërkueme (10% të çmimit) Kryetari i Komisionit, përpara antarëve këndon letër shpalljen tue thanë kërkuesavet se në pjesën...e pyllit...shes Nr. ...drue ...në kambë, të shënjueme e të caktuem në metro kub ...te papunuem, për m³ fr. Ari...kush don me i ble të çojnë doren.

Për në kjoftë se prej të gjitha lutsavet, vetëm një ngrehë dorën, atëherë m'a cast shitja njihet e baeme (me ixhab e Kabul), e depozita e njohun përpara Komisionit njiherit i dorzohet Arkës së Financës e blesit i nepet dora e Arkes; të tjerat depozita i këthehen gjithsejçillit.

Për në kjoftë se mbas fjalës së Kryetarit të Komisionit, asnjë nga lutsit nuk ngrehë dorën atëhere Kryetari në fjalë, mbas një pritjes tre minutavet, do të rrëzojnë një pjesë të vogël të çmimit të shitjes, po kje prap se asnjë nuk ngrehë dorën, me radhë disa herë e me pritjet e caktueme si ma sypr, do të rrëzojnë çmimin e ma parë folun sat ë mërrijnë m'at të caktuemin në letër shpalljeje.

Po kje se edhe në çmimin e caktuem në letër shpalljeje, as një nga lutsit nuk ngrehë dorën, atëherë Kryetari i Komisionit do të lajmërojnë se shitja nuk bahet.

Çmimi i parë, qi do të rrëfejnë Kryetari i Komisionit do të kapërcejnë një të tretën e çmimit të caktuem në letër shpalljeje.

Çdo shitje do të bahet veçanerisht e me të gjitha formalitetet e nalt-përmenduna e pa marrë para sysh numrin e kërkuesavet edhe si kur të jen një i vetëm.

Për në kjoftë se për të gjitha shitjet nuk mjjfton dita e caktueme, atëherë të mbetunat lehen për nesor, ose mbasnesrit, për në kjoftë se dita qi ndjekë atë të shitjes asht njoftun zyrtarisht e kremte.

Kërkimet qi të bajnë ndonji lutës për të mos gjetunit e tij, ose mbas të mbajunit me dërgue ndonji perfaqses në ditën e n'orën e caktueme të shitjes, edhe sikurse këto të jenë të pështetuna n'arsyena të plota, nuk merren kurrsesi përpara sysh e shitja vazhdon rregullisht.

Drurët, qymyri e prodhime të tjera të pyjeve të Shtetit, qi shiten me peshim ashtu edhe kullosat i shtohen plotsisht formalitetet të caktueme ne ketodispozita te ligjit.

Mbasi veprimet e shitjes të gjejnë fund perpara komisionit të formuem mbi çashtje, do të bahet një protokol (zapname) i cili do të nënshkruhet prej antarve të komisionit, prej blesit Zyrës së Pyjeve.

Nëpunësit teknik i pyjeve, mbrenda 5 ditëve, do të marrin blesin, ase

njerin e tij, e do të vejnë së bashkut në pyllë e do të damkosin cn. 10 ma nalt të N-r renduer ma parë vuem, të gjith drurët e shitme.

Mbassi të marrin fund të damkosimit e drurëvet, do të formohet listë-damka e do të nënshkruhet nga nëpunsi ekzekutiv, nga kryerorjari I asaj krahinë e nga blesi ose njeri i tij, e kështu plotsohet dorimi e dorzimi i drurëvet të shitme.

Dorimi e dorzimi i drurëvet të zjarrit e qymyrit, plotsohet tue i diftue blesit copën e pyllit e vendin e furrave ku do të djeget qymyri, dhe protokoli i dorimit e dorzimit, e do të nënshkruhet prej dy antarvet.

Drurët e prodhimet të tjera pyjore, qi janë doruë e dorzue si mas artikullit 87, 88 qysh prej datës së listë-damke e të protokolit, janë gjaja e bleme e blesit e prandej të rujtunit e tyne i përket blesit, pse Shteti nuk pranon ndonji pergjegjsi per ndonji dam qi mund t'i ndollin.

Protokolet e bamuna si nga ana e shitjes, si në rasë të dorzimit e të dorimit, do t'i paraqiten pa vonesë me një shkresë prej zyrës së Pyjevet, Këshillit Administratuer, i cili mbrenda 5 ditvet mbas datës së shkresës, do të përmbajnë mbi to një protokol, tue dishmue përfundimin e shitjes. Massi t'i këthehet protokoli bashkë me të tjera akte, zyra e Pyjevet do të formojnë kontratën me kondicjone si mbas nevojave e në dy kopje të nënshkruyeme prej nëpunësit e blesit, e mbassi të vërtetohet, njenën kopje do t'a mbanjë zyra e Pyjevet e tjetrën blesi.

Blesi do të jenë autorizue me pre e me punue drutë e blame, mbas datës së vertetimit të kontratës.

Po kje se Këshilli Administratur nuk mban protokolun e përmendun n'art 90, mbrenda 5 ditëve, atë herë nëpunësit i Pyjevet, për të mprojtun të drejtat e blesit, nga vonesa e veprimevet do të formojnë e të këmbëjnë kontratën.

Për në kjoftë se mbas datës së shitjes mbrenda 30 ditvet, pa ndonji shkak t'arsyeshem nuk përfundohen veprimet e dorimit e dorzimit, e mbrenda 50 ditavet nuk merr fund nënshkrimi, e këmbimi i kontratës, shitja atëherë pa fjalë bjen poshtë (anulohet), e depozita e bame nga ana e blesit, llogaritet n'Arkën e Shtetit.

Mund të bahet shitje pa shpallje për të prem të druvet nder pyjet e Shtetit, e tue u përmbajtë një vendim të Këshillit Admijnistretuer, si mbas çmimit të listës, atëherë, kur t'a kerkojnë nevoja e popullit për ndonji përmirësim të Bulqesis e të Industris së landës së vendit ase të zotnuesavet të sharravet.

Sasija e shitjes nuk do të kapërcejnë prej 10 deri më 100 dru.

Për t'u nda këta dru, prej atyne të shitunavet me shpallje, njyra e numrit renduer dop të ndryshonjë, e damka do të veht për së mbrapshti, e nën numër renduer.

Katundarëvet qi sigurojnë gjallnimin e tyne, betëm me tregti të druvet e të qymyrit, do t'i nepet leje me pregaditë prej 50 deri më 100 Ql. qymyr pa shpallje, vetëm me një vendim të Keshillit Administruer e si mbas çmimit të caktuem në listë.

Shpallja e kullosavet verore e dimnore të Shtetit, bahet në stina të ndryshme: për verorjet në të parën ditë të Frorit, e për në kjoftë se e doemosdoshme, shtyhet deri në Marc; për dimnoret ditën e parë të Gushtit.

Katundarët kan të drejtë me kullotë bagtit nder kullosa verore e dimnore qi gjinden mbrenda kufinit të Katundit, pa pague ndonji taksë edhe përse katundit nuk i asht dhanë e drejta si mbas caktimit të Kodit Rural; e vetëm për bagti qi do të vijnë prej katundevet a rretheve të tjera, do të merrret taksa për ç' do krenë të

Vijon në fq. 7

Midis kolegëve rumunë

Dr. ARBEN PETTO

Me ftesë të Dekanit të Fakultetit të Silvikuturës dhe Inxhinierisë Pyjore Brashovë, bëmë një vizitë pune në këtë Fakultet, së bashku me Profesorët e mi Panajot Koçi e Mihallaq Kotro.

Me të zbritur në aeroportin "Otopen" të Bukureshtit na uroi mirëseardhjen Ing. Costea Ion, ish-student në Fakultetin e Brashovës, i cili për nder të ekipit shtrori një drekë në restorantin "Select", një nga më të mirët e qytetit. Pastaj, për disa orë, shëtitëm në vendet më të bukura të Bukureshtit dhe u nisëm për në Brashovë, një nga qytetet kryesore të Rumanisë, rreth 160 km larg Bukureshtit. Rruga automobilistike kalon përmes fushave të mbjella me grurë, gati për t'u korrur, si edhe nëpër një brez pylli me lloje fletorësh (dushqë). Pasi kalon qytetin e Ploeshit dhe lë prapa vapën e madhe, rruga ngjitet nëpër kodrina të veshura me pyje të



pafund me ah e halorë të ndryshëm, derisa mbërrin në disa qyteza turistike, që njihen nga shumë vende të botës, si Sinaja, Prediali, Bushteni, Breza, etj.

Meqë Prof. Panajoti ka kryer studimet në Fakultetin e Pyjeve të Brashovës, para 50 vitesh, na priti



shokun i tij i klasës, i cili ishte në Komitetin organizator të festës, i quajtur Mircia Asmarandei, me të ilin shkëmbyem mendime lidhur me gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë pyjore në dy vendet tona.

Rumania është një nga vendet e zhvilluara dhe me traditë në fushën e silvikulturës dhe të industrisë së drurit. Ajo ka prodhuar makina e pajisje nga më të mirat, siç janë motosharrat

kërkohen rrugë e metoda të reja sepse shfrytëzimet e pyjeve bëhen nga kompani private të licensuara.

Nga disa të dhëna të Shoqatës së Pylltarëve nxorëm këto të dhëna:

1. Fondit pyjor 6.4 milionë ha
2. Sipërfaqja e pyjeve 6.2 milionë ha
 - Halorë 1.9 milionë ha
 - Ah 2.0 milionë ha
 - Dushqë 1.2 milionë ha
 - Të ndryshme (fletorë) 1.1 milionë ha
3. Masa drusore në këmbë:
 - Vëllimi total 1350 milionë ha
 - Vëllimi mesatar 217 m³/ha
 - Rritja vjetore totale 34.7 milionë m³
 - Rritja mesatare 5.6 m³/ha

Nga shfrytëzimi i pyjeve dhe përpunimi i drurit realizohen rreth 20 asortimente.

Industria pyjore në ekonominë e Rumanisë përfaqëson 3.5 % të GDP, rreth 7 % të vëllimit të industrisë përpunuese, 9.6 % të eksportit, 1.2 % të importit, 9.3 % të numrit të punësuarve të industrisë.

Pritja që na u rezervua në Fakultetin e Silvikuturës dhe i Inxhinierisë Pyjore ishte shumë mbresëlënëse. Dekani, Prof. Dr. Ing. Ioan Abrudan, një djalë i shkathët e shumë i gatshëm për të na treguar çdo gjë nga eksperiencia e tyre në fushën e pyjeve dhe të arsimit universitar. Megjithatë ato ditë ishin në sezonin e provimeve, ata gjetën kohë për të qëndruar e diskutuar me ne dhe për të na krijuar kushte sa më të mira.

Ditën e dytë të takimit me pedagogët e Fakultetit dhe me disa punonjës të prodhimit, mbajtëm një leksion me temë: "Pyjet e Shqipërisë - Realiteti dhe perspektivat". Leksioni u ndoq me interes e vëmendje, u bënë pyetje e diskutime për probleme të ndryshme. Pas leksionit përsëri në dekanat, ku u diskutua për planin e programin mësimor të këtij Fakulteti. Diskutime

e mendime u shfaqën edhe për sistemin e Bolo-njës, për anët e mira dhe mangësitë. Në këtë Fakultet dy vitet e para studentët janë me programe të përbashkëta, ndërsa tretin ndahen në specialitetet silvikulturë e inxhinieri pyjore. Në Rumania, përveç këtij Fakulteti, që është më i vjetri, janë edhe dy të tjerë më të vegjël.

Për industrinë e drurit ka një Fakultet të veçantë. Aty na priti zv-dekani, i cili na njohu me të gjitha mjediset, auditorë dhe salla laboratorësh. Na bëri përshtyje salla me prodhime prej druri shumë cilësore, të realizuara nga vetë studentët gjatë praktikave laboratorike. Zv.dekani theksoi se makineritë dhe pajisjet e këtij Fakulteti janë nga më të mirat në Europë. Përveç zv.dekanit na shoqëroi edhe Prof. Virgil Istrata, tashmë në pension, por ishte konsulent për doktorantët. Ai na foli me pasion për punën që bëhet në këtë fakultet dhe u interesua të dinte edhe për disa kolegë të tij në Shqipëri, si Ing. Jak Pajolli, Ing. Ali Konica e Ing. Ilo Shqahu, që nuk jetojnë. Prof. Istrata na premtoi për një bashkëpunim të ri me departamentin e industrisë së drurit në fakultetin tonë.

Në të dy fakultetet u diskutua për të ardhmen e ekonomisë pyjore në vendet tona. Rol me rëndësi për zhvillimet e këtij sektori, ashtu si deri tani, do të luajnë specialistët. Për këtë, ata duhet të jenë në drejtimit e sektorëve apo të drejtorive të shërbimit pyjor. Në asnjë mënyrë nuk duhet që në këto vende të vihen kuadro jashtë profilit apo militantë partie, siç ka ndodhur në disa raste tek ne. Në formë të prerë, Dekani i Fakultetit tha: "Vetëm ministri mund të jetë me profil tjetër, ndërsa që nga zv.ministri e deri te përgjegjësi i sektorit duhet të jenë specialistë pyjesh".



Sipas Prof. Panajotit, i cili ka qëndruar këtu 5 vjet, Brashova e vjetër i ka ruajtur të veçantat e saj. Qyteti është zhvilluar në drejtime të ndryshme, janë ndërtuar godina banimi, bulevarde e lulishte nga më të bukurat, por ruhen edhe kishat e vjetra e madhështore, teatri dramatik, hotelet luksoze, shtëpitë karakteristike me çati të tipit alpin, muzetë, etj. Brashova është qyteti i kulturës dhe i arsimit. Këtu është shkolla e parë rumune, ka disa gjimnaze, rumune, gjermane e hungareze. Tani në Brashovë është universiteti "Transilvania" me 16 fakultete.

Ditën e tretë, para Fakultetit të Silvikuturës u mblodhën 60 ish-studentë për të festuar 50 vjetorin e mbarimit të studimeve të larta, ndër të cilët edhe ish-studenti shqiptar, Prof. Panajot Koçi. Për atë kjo ishte një ditë e veçantë, sepse kujtohet me nostalgji periudha më e bukur e jetës, ajo e rinisë, që nuk vjen më. Gjatë kësaj periudhe 50 vjeçare secili kishte kujtimet e veta. Në sallën festive, ku u bë aplodi i 120 ish-studentëve, doli se rreth 40 nuk jetonin. Aty nuk u mbajtën referate apo fjalime. Takimi ishte i përmallshëm dhe u mbyll me dëshirën për një takim në vitin 2013, për 55 vjetor, duke i uruar njëri-tjetrit shëndet dhe fëmijëve, nipave e mbesave jetë më të lumtur.

Nëpërmjet këtyre radhëve, duke vlerësuar diskutimet dhe shkëmbimin e përvojës, falenderojmë dekanatin për pritjen e përzemërt që na u bë. Le të shpresojmë që të takohemi përsëri, tashmë në vendin tonë.

Brashovë, korrik, 2008

LIGJI I PYJEVE E KULLOSAVE

Vijon nga fq. 6

vogël Fr. Ari 0,40 (2 grosh) e të madh Fr. Ari 1,20 (6 grosh).

Për kallama, zhukë etj, për të gjujtun se gjasë së gjallë, po të nepet leje prej zyrës së Pyjeve, me të cillën do të dishmohet se asht pague rregullisht taksa e caktueme prej Qeveris së vendit.

Të nxjerrunit jashta pyllit, landë e prodhime të tjera, bahet me "Diftesë Bartje" diftesë e cilla dishmon se janë marrë të hollat e gjasë së qitun jashta pyllit.

Ne Kreun IV percaktohej mënyra e përgatitjes dhe të paguarit e druveve e prodhimeve të tjera nga pyjeve dhe kullotat.

Vlefta, per sasisen e druveve qe do të prodhoheshin nga Pyjet shtetore brenda një viti, dorezohet ne Arkën e Shtetit para se të fillonin veprimet/prodhimi i tyre. Në raste të mos pagimit të vlefes perkatese, zyra e Pyjeve kishte të drejtën të ndalonte prodhimin e lendës brenda pyllit dhe e quan si të konfiskuar. Blesi ishte i detyruar te fillonte procesin e prodhimit te lendes drusore vetem pas nenshkrimit te kontrates si dhe te respektonte kushtet e saj. Po ashtu, bleresi, ne raste te pamundesise se prodhimit e transportit te materialit drusor brenda afateve te caktuara ne kontrate, nuk kishte te drejte per te

mos paguar te hollat apo dhe te kerkonte diferencen per materialin e mosprere.

Për rastet e dhenies me konçension, për disa shkaqe te arsyeshme, të verteta e ligjore nuk mundet te prodhohej apo te transportohej lenda e planifikuar, kerkohej qe zyrës së Pyjeve, përpara se të perfundonte afati i caktuara, ti drejtohej nje lutje/kerkese per shturjen e afatit e cila shqyrtohej nga zyra e pyjeve dhe jepej nje afat i ri.

Ne artikujt e mevonshem (104-108) jepeshjin dhe menytrat e pagimit te lendes te cilat po i citojme si ne orgjinal:

Blesi për depositën e përmendun syprri mundet me paraqitë një dorzanës, qi të jen i pëlqyeshëm e i respektueshëm si mbas ligjës, i cili do të jen i detyruem e me I përgjegjë dorzani pa farë kundrështimit e pa kërkue ndonji vendim të gjykatores tue i mbetë e drejta me pre e me punue druin.

Të hollat e druvet të blame a të prodhimevet të tjera pyllore do t'i dorzohen nga ana e blesit Arkës së Shtetit e përto do të marrin një "Dorë Arke".

Taksa e druve ase të prodhimeve të tjera pyjore, qi do të priten e do të nxjerren nga pyjet e korijet private e të Bashkivet, do të dorzohen në Arkën e Shtetit përpara se të dalin jashta pyllit gjaja.

Çmimi e taksa e druvet e të prodhimevet të tjera pyjore, qi do të priten, të punohen e të pregatiten

nder pyjet e Shtetit privat e të Bashkivet do të nxjerret përpara se të nxjerret gjaja jashta pyllit.

Çmimet e kullosavet Shtetnore do të merren e të nxjerren si mbas afatit të caktuem në kontrate.

Ne Kreun V jepen rregulla lidhur me prodhimin, përpunimin e transportin e druve te shitura.

Blesi asht i detyruem me pre druët e blame e të dorueme për syprri shejit të damkës e të numrit renduër e pa i prishë këto, tue pasë për kujdes mos me damtue majet e drëve të tjera në rasë të rrximit të druveve të preme, e mbassi këto të hetohen nga ana e zyrtarit do të qiten jasht copës së pyllit e do të çohen në vend të punimit.

Druët e premë qi do të barten në vend të punimit për m'u punue, ose do të barten me anën e një lumit sikurse janë, ase të ndame ndër trupa, para se të nxirren nga copa e pyllit, do t'iu vehet nga anët e kryerjartit, numri atyne druëve qi janë pre, tue shenjue në një libër cirkoferencën e mjesme e giatsin e çdo trupi.

Per në kjoftë se ndër druët e preme gjindent ndonji qi asht e shkueme dam, e preme o e kalbun, blesi pa luejt druët prej vendit, do të lajmërojë krye-rojtarin, e mbassi të vërtetohet landa e shkuëme dam prej nëpunsit teknik e me një process-verbal, do t'i nepet e drejta blesit me pasë në vend të sajë një tjetër të shndoshtë, qi të ket masat e llojin e së parës, e tuej i vue Nr. Renduer e damkën qi ka pasë ma para.

Për në kjoftë se blesi ase puntorët e tij, pa dashtë, damtojnë majet e ndonji drunit, e vërtetohet pa dashtuëm do t'i lehet blesit tue e pague si mbas çëmimit të caktuëm për të tjerat.

Drutë e trupat e premë të cillyet i u asht vue numri prej krye-rojtarëve si mbas Art. ma syprri, para se të barten në vend të punimit a në breg të lumit do të hetohen nga ana e Nëpunësit Teknik numri e damka e druvet (kërcujt) nga të cillët janë pre këta trupa. Për në kjoftë se nuk shifet ndionji vepër e jashta ligjeshme, formohet process-verbal, e i u vehet damka e tyne trupavet e druvet qi u ishte vue numri ma parë nga kryerjartari.

Si trupat e drutë qi do të barten me lum, në detë, n'udhë hekuri e me qerre, ashtu edhe çdo landë e latueme e punueme e e pregatitun në rruga qi janë ndermjet të pjesavet, a nder vende të hapta të pyjevet, ase në sharrë e vende të tjera të punimit, para se të barten do të damkosen prej Nëpunsit Teknik edhe të nepet një diftesë e cilla përmban masat, sasin, edhe dishmon se gjaja e naltpërmendun asht punue nga drutë e blame.

Landa peshuemit e e papunueme qi qitet jashta pyllit pa damkë e diftesë bartje, si mbas shenimevet të dy Art. naltpërmendun, quhet kontrabandë.

Landa peshuemit e druvet të zjarmit, të qymyrit ase të prodhimeve të tjera, bahet në vend ku janë

pregatitë, edhe të nxjerrunit e tyne jashta pyllit bahet me "diftesë bartje".

Puntorët qi do të blerësi për të prem, të transportimit të druvet të blame, do të jen të gjith nënshtetas shqypetarë.

Për këto veprime parapëlqehen, shtihen në punë ata puntorë të katundevet ase të qytetevet qi janë për qark të pyllit e qi janë të marrun me punimin e landës, me pagë e me kondicjon të njinjishme të puntorëve qi vijjnë nga së jashmi.

Për në kjoftë se dishruerat me marrë pjesë nder veprimet pyjore janë të shumë, e nga katundet për qark të pyllit blesi asht i detyruem me marrë si mbas proporcjonit nga sejcilli katund nga pak puntorë.

Për në kjoftë se blesi don me ngrëhë një sharrë në pyllë, zyra e pyjevet do t'i napin lejen, me kondicjon qi në mbarim t'afatit të kontratës, gjith goditja, perposë së veglavet e hekurishtavet të tjera, do t'i ngelin Shtetit pa të holla; leje e cilla lidhet me një vendim të Këshillit Administratuer të vendit.

Landa e Pyjevet e e korijevet private e të Bashkivet, do të qitet jashta pyllit, mbassi të damkoset prej zyrtarit të pyjevet e me diftesë bartje.

Landa e djegëshme (kombustible) qi do të bartet nga pyjet e korijet private, do të peshohet prej zyrtarit të pyjevet e do të nxjerret me një diftesë.

Main Findings of MID TERM REVIEW MISSION

June 9-25, 2008

A Mid-term review Mission of the World Bank and Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) and Dutch Organization for Development (SNV) was carried out from June 9 -25, 2008, to assess the progress in the implementation of the Albania Natural Resources Development Project (NRDP).

Main Mid Term Review Findings

Achievement of Project Development Objective

In terms of implementation, the mission noted that the progress of the Project is characterized by a substantial improvement of Project efficiency and acceleration in achieving targets for Communal Forest and Pasture management Plans (CFMPs), Micro-Catchment Plans (MCPs) and Carbon Sequestration (CS). The Project is largely on track implementing the new Project implementation plan approved by the MOEFA in November 2007. The formalizing of forest and pasture transfer to local government units (LGUs) confirms that the Project Development Objective (PDO) remains high in the Government's agenda. As part of an ambitious plan of decentralization of governmental powers to LGUs, agreements for the transfer of ownership of forests and pastures have been signed by the Council of Ministers for 330 communes. It concludes a process which began in 1998 as a pilot for the transfer of usufruct rights to 30 communes, as part of the Albanian Forestry Project (AFP). However, this achievement significantly changes the project situation and a major aim of the project becomes building management capacities for sustainability at the local level.

As result of transfer, there is an urgent need to adapt the institutional framework to be able to deliver adequate capacity building, extension service and control functions. This was an important aspect of project design which has become even more important when not only the usufruct, but also the ownership rights of land have been transferred.

Sustainability

The transfer of ownership and usufruct rights for forest and pasture management to the LGUs provides better incentives to manage and protect these resources, which are now closer to the people that use and protect them. The Decision of the Council of Ministers, No.22, date 9.1.2008, provides a framework to establish and maintain sustainable and community-based management of communal forests and pastures.

LGUs and the communal forest and pasture associations (CFPUAs) have gained important skills and experience, which is a good base for their future work to improve management of the resources and increase their revenue potential. The participatory process has the added value of not only increasing ownership through the process of identifying boundaries and individual usufruct rights, but also exposing the community to ideas of sustainable management practices.

Along with the transfer of pasture and forest lands to the communes, a new opportunity for sustainable use of pastures is opening up in the form of grazing fees. These fees were formerly collected by District Forest Service, but now, after the transfer is finalized, they will be collected by the communes. The mission believes that a well managed fee setting mechanism could be a way to provide a disincentive to overgraze certain areas and an incentive to graze underutilized areas. Moreover, the income generated from the fees could be reinvested in pasture management and improvement of their quality.

One of the stated reasons for Government's Decision to transfer forest and pasture to communes was to ensure better protection and management of these resources in general, and better fire control in particular. LGUs feel that fire management will be less of an issue now that the forest and pasture lands are transferred to communal ownership as the people, who are often setting the fires, will now see those lands as of their own and will therefore take better care to prevent wildfires. However, in order for the communes to take full advantage of the above opportunities and the project to be sustained



after its closing, it is crucial that supporting structures for building management capacity are in place. This is closely related to a successful institutional reform for the control and management of forests and pastures. The transfer of state forests and pastures to communes requires a substantial reorganization of institutional functions and reallocation of resources. The logical continuation of the PMT and the DFPP after the closure of the project would be to become the central Directorate responsible for forest planning and extension to commune and private forests and pastures. Unless the required reform is completed within the project period, sustainable development of upland and mountainous erosion-prone areas now transferred to the communes may not be secured and maintained.

Because government resources are limited and most likely will be inadequate to meet future demands, it is now the right moment to explore alternative sources of revenues which could contribute to the financial viability of LGU economies. There is a need to provide disadvantaged mountain regions with continuous structural support as is the case throughout the European Member States and in many other countries. Most of the communes will not be in a position to secure critical livelihood, environmental and other functions and to rebuild the forest and pasture resources in a way that they can provide a sustainable source of income for their inhabitants. Albanian forest and pasture resources produce a multitude of environmental services such as erosion control, stabilization of water supply and improvement of water quality, and enhancement of national and global biodiversity, as well as providing the foundation for a vibrant cultural and environmental tourism. In many countries, such as Mexico, Costa Rica, and Panama, payments for environmental services (PES) have already become a viable additional source of income and have helped to improve land use and reduce environmental problems. The mission therefore believes that PES would have a great potential in Albania and suggests exploring its development for certain watersheds or the country as a whole. One example with an obvious potential would be Fierza commune where payments in collaboration with Albanian energy corporation KESH and the General Roads Directorate to protect forests against erosion on steep slopes would largely offset the costs for structural protection of the road and lake. For this, the Mission recommends the carrying out of the needed analytical work, with support of an internationally recruited specialist, who could help develop a better understanding of the PES mechanism for the Albanian situation, based on in the experiences of Mexico and Costa Rica.

KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Tiranë

Këshilli Botues:

N. Çollaku, Th. Lako, M. Kotro, J. Male, F. Memeli, A. Diku.

Kryeredaktor: AHMET OSJA

Zv.kryeredaktor: FERDIN LIÇAJ

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, Z. Ymeraj.

Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Mobile: 068 23 23 360; 069 21 11 333; 068 21 42 098

e-mail: velihoxha@yahoo.com

kurora_gjelber@yahoo.com



The International Land Coalition is a global alliance of intergovernmental, governmental and civil-society organizations. The Coalition works together with the rural poor to increase their secure access to natural resources, especially land, and to enable them to participate directly in policy and decision-making processes that affect their livelihoods at local, national, regional and international levels.



Connecting People's Capacities

